



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Sociologji”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Dr. Genti Kruja

2. Dr. Merlina Koseni (Pograzha)

Mars 2023

Për Programin e studimit Bachelor në “Sociologji”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Sociologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Sociologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 352, datë 09.07.1993
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/25 PAK v.a. 2021-2022 9 PAE/21 PAK v.a. 2020-2021 9 PAE/19 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	94 Studentë v.a. 2020-2021 106 Studentë v.a. 2019-2020 102 Studentë v.a. 2018-2019
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit “Bachelor” në “Sociologji” ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë, në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës. Ai është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi, duke përbërë të vetmin program studimi të ciklit të parë të studimeve që ofron ky departament. Ky program u hap me anë të Vendimit Nr. 831, datë 04.06.2008. Kohëzgjatja e programit të studimit është 3 vite akademike, me 180 kredite, përkatësisht 60 kredite/vit dhe 1.500 orë në vit.

Programi, në gjuhën shqipe, është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi përfundon me marrjen e diplomës “Bachelor” në Sociologji.

Kurrikula e programit të ofruar për nivelin Bachelor rezulton se është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve nga vende të ndryshme të botës. Lëndët sociologjike, që zhvillohen në këtë cikël studimesh kanë edhe profil kombëtar, që realizohet nga një numër i konsiderueshëm studimesh sociologjike, artikujsh shkencorë dhe punimesh monografike për shoqërinë dhe kulturën shqiptare të botuara nga pedagogët e Departamentit të Sociologjisë. Diploma “Bachelor” në Sociologji është njohur në të gjitha vendet perëndimore. Këtë gjë e dëshmon fakti që studentët e diplomuar në programin Bachelor, kanë vazhduar studimet Master në vende të ndryshme të botës. Po ashtu edhe ata që kanë ndjekur një ose dy vite pranë departamentit të Sociologjisë janë transferuar në të njëjtin cikël studimesh në universitete perëndimore.

Programi i studimit Bachelor në “Sociologji”, me strukturën e përmbajtjen e tij është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e shkencave sociale. Ai synon objektivin për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve, si dhe përgatitjen e tyre si kuadro të shkencave sociale. Programi ka si qëllim të formojë ekspertë, të aftë për të punuar në organizma arsimorë, socialë, kulturorë, etj., pranë institucioneve kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qasje ndaj problematikave sociale e kontributit të komunitetit.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për organizimin e ASCAL, dhe në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga instucioni për akreditimin e programit Bachelor në “Sociologji”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Dr. Genti Kruja dhe Dr. Merlina Koseni (Pograzha). Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.


Raporti është përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr. 77, datë 01.07.2022 në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universiteti i Tiranës, dokumentacionin shoqërues të raportit dhe në vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 26-27.07.2022. Po ashtu, GVJ është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Universitetin e Tiranës, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji” nën vlerësim, me anëtarët e departamentit, përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale, si të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, Bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

Më datë 03.02.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/22 Prot., datë 03.02.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes sistemit AMS, datë 15.02.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 461/1 Prot., datë 17.02.2023 nga ASCAL, ku shprehu dakordësinë e saj lidhur me përmbajtjen e DRVJ-së. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Sociologji”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti i Tiranës është universitet publik, që ofron programe në të tre ciklet e studimit, duke u mundësuar studentëve një qasje të gjerë, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programet e studimit në UT kanë për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencës në shërbim të lirisë e diversitetit të mendimit, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.</p> <p>Bazuar në nenin 8 të Statutit të Universitetit të Tiranës, UT-ja vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore e ato evropiane.</p> <p>Sipas nenit 4 të Statutit të Universitetit të Tiranës, UT synon të mbetet model i arsimit të lartë publik, i karakterizuar nga përgatitje akademike dhe kërkimi shkencor.</p> <p>Në këtë kuadër, Departamenti i Sociologjisë, ofron cikle studimesh me programe me profil kombëtar, që realizohen nëpërmjet studimeve sociologjike, artikuj shkencorë dhe punime monografike për shoqërinë dhe kulturën shqiptare të botuara nga stafi pedagogjik i Departamentit të Sociologjisë.</p> <p><i>[ref: Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), evidenca 246; Mësimdhënia dhe studimet, fq. 6, evidenca 1.4; Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 1.2; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, pika II, sfondi aktual, evidenca 3.5].</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti i Tiranës është një universitet publik, që realizon misionin e tij përmes: kërkimit shkencor, edukimit, si dhe shërbimit ndaj publikut, duke synuar edukim me në qendër studentin, si dhe nxitjen e rritjes personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale, bazuar këto dhe në nenin 5 të Statutit të UT. Ndërsa sipas nenit 4 të këtij statuti, Universiteti i Tiranës synon të angazhohet në transformimin e jetës së studentëve dhe të shoqërisë. Sipas “Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës”, zhvillimi i partneriteteve dhe i bashkëpunimeve afat-mesëm dhe afat-gjatë, rrisin vlerën kombëtare dhe ndërkombëtare të Universitetit të Tiranës.</p> <p>Bazuar në kornizën konceptuale të programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji, ky program ofron një mësimdhënieje cilësore dhe një</p>

	<p>kurrikul bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Programi konsideron si pjesë të vizionit të tij promovimin e vlerave kulturore kombëtare në kontekstin ndërkombëtar, nëpërmjet studentëve të ekselencës si dhe nëpërmjet kurrikulës dhe përmbajtjes së programit. Ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike dhe kombëtare shprehet dhe në planet lëndore të programit të studimit.</p> <p><i>[ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 243; Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), pika 2.1.1, evidenca 1.4.; Korniza konceptuale e programit të Studimit 'Bachelor në Sociologji'. Pika 3, evidenca 4.1; Strategjia e zhvillimit të programit "Bachelor" në "Sociologji", pika 3. Vizioni, evidenca 3.5; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Sociologji", evidenca 4.3.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë ofron programe studimi sipas niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në harmonizim me misionin e Universitetit të Tiranës.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Fakulteti i Shkencave Sociale, në përmbushje të objektivave strategjike të Universitetit të Tiranës, synon që të ofrojë edukim të nivelit të lartë mësimor e shkencor në Shqipëri në fushën e Sociologjisë.</p> <p>Programi ka synim realizimin e një kornizë kurrikulare me qasje kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhimin e një stafi akademik me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, pjesëmarrje të studentëve në nisma të pavarura (kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare) dhe në kërkimin shkencor.</p> <p><i>[ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 5: Misioni, evidenca 1.2; Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit, evidenca 2.6; Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3), evidenca 3.3.1; Strategjia e zhvillimit të programit "Bachelor" në "Sociologji", pika 3. Misioni dhe Vizioni, evidenca 3.5; Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor" në "Sociologji", neni 1, pika 1.2, evidenca 3.6].</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Bazuar në "Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës", dhënia e kontributit real në prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aplikuar në UT realizohet në përfitueshmëri të ndërsjellë ndër aktorët e hapësirës akademike dhe të biznesit. Universiteti i Tiranës përmes programeve të studimit, synon t'i përgatisë studentët për konkurrencën në tregun e punës, duke ndikuar në krijimin e një pasurie shoqërore, që në tregun e punës të ketë një impakt pozitiv për zhvillimin kombëtar.</p> <p>Bazuar në "Strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë, programet e studimit hartohen, përshtaten dhe përmirësohen në funksion të përmirësimit të potencialeve të rinisë për t'i shërbyer zhvillimit shoqëror.</p>

	[ref: Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), pika 1, 2.1.7, Mësimdhënia dhe Studimet, evidenca 1.4.; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji” (2020-2024), prioriteti strategjik: zhvillimi i kurrikulës, evidenca 3.5.; Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë, prioriteti strategjik: mësimdhënia dhe zhvillimi i kurrikulës, evidenca 3.2.; Korniza konceptuale e programit të Studimit “Bachelor në Sociologji”, pika 3, evidenca 4.1.].		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në bazë të evidencave vihet re se Universiteti i Tiranës ka hartuar dokumente, ku përcaktohet orientimi për hartimin dhe zbatimin e programeve të studimit. Sipas raportit të GVB-së dhe Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), të gjitha programet e studimit në UT nxisin mendimin kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debat i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike.</p> <p>Bazuar në strategjinë e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, ky program është i harmonizuar me Statutin e UT dhe Strategjinë e UT 2018-2023. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” është hartuar duke u bazuar, përveç të tjerash edhe në Strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023).</p> <p>[ref: Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), Pika 1, 1.2.12. Mësimdhënia dhe studimet, evidenca 1.4.; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 3.5.; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 1. Pika 1.2 Misioni, evidenca 3.6.].</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Bazuar në Rregulloren e UT, versioni 2016, neni 31, programet e studimit në Universitetin e Tiranës hartohen nga vetë njësitë bazë akademike të universitetit dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Sociologjisë, programi i studimit “Bachelor” në “Sociologji” është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë dhe statutin e rregulloren e Universitetit të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë.</p>

	<p>[ref: Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2016 e përditësuar. Neni 31, organizimi i studimeve, evidenca 1.3.; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, evidenca 3.5.; Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’. Pika 2, evidenca 4.1.]</p>		
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit në ciklin e parë “Bachelor” në Sociologji ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, sipas standardeve ndërkombëtare të arsimit të lartë, ku ofrohen gjithashtu programe studimi edhe në fushën e psikologjisë, edukimit, shkencave politike, si dhe punë e politika sociale.</p> <p>Sipas evidencave kurrikula e programit ka në fokus thellimin e njohurive në shkencat sociale, si dhe ky program, me strukturën e përmbajtjen e tij, është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e shkencave sociale.</p> <p>Hartimi i programit të studimit, syllabusve të lëndëve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në vendin tonë dhe ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe veçanërisht Departamentit të Sociologjisë, të cilat janë përqendruar në zhvillimin e sociologjisë së familjes, sociologjisë gjinore, sociologjisë rurale, sociologjisë urbane, sociologjisë së migrimit, sociologjisë së nacionalizmit, sociologjisë së edukimit, drejtësisë sociale, drejtësisë restauruese, kriminologjisë sociale, sociologjisë së deviancës, sociologjisë së përfshirjes, sociologjisë politike, sociologjisë të së drejtës, sociologjisë së njohjes dhe artit, sociologjisë së imazhit, sociologjisë së kulturës, sociologjisë së komunikimit dhe medias, sociologjisë së punës, etj.</p> <p>[ref: Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit, evidenca 2.6.; Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’, evidenca 4.1.; Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2016 e përditësuar. Pjesa III. Organizimi i strukturës, përmbajtjes dhe elementëve të studimeve, evidenca 1.3.; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, neni 6, evidenca 3.3.]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Sociologji” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve. Oferta akademike e studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji” është konceptuar për të formuar një brez të ri të formuar me një vështrim objektiv dhe</p>

<p>profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>kritik në shoqërinë në përgjithësi, për të ndikuar zhvillimet shoqërore dhe zhvillimet e politikave të ndryshme.</p> <p>Këto objektiva pasqyrohen gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet guidës së studentëve, i bëhet e qartë studentëve misioni e objektivat formuese, si dhe kompetencat dhe aftësitë, që përftohen nga ndjekja e programit të studimit. Duke qenë se në fokus të programit është kërkimi shkencor në fushën e sociologjisë, studentët përpara fillimit të procesit mësimor, marrin edhe trajnim për përdorimin e bibliotekës.</p> <p><i>[Ref.: Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor" në "Sociologji" neni 10, evidenca 3.6; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1.; Programi i lëndës hartohet nga titullari i saj sipas formatit të standardizuar me VKM; Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor" në "Sociologji", neni 11, programi i lëndës, evidenca 3.6; Në këto programe lëndësh paraqiten qartë objektivat e lëndës, në përputhje me objektivat e programit të studimit; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3; Korniza konceptuale e programit të Studimit 'Bachelor në Sociologji', evidenca 4.1.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar dhe në RVB, institucioni kryen në mënyrë periodike studime mbi nevojat e tregut të punës për programet e studimit.</p> <p>Kështu Departamenti i Sociologjisë ka realizuar në vitin 2021 një studim tregu, bazuar në punësimet e të diplomuarve nga ky departament gjatë viteve 2018-2021. Studimi i tregut të punës nga ana e departamenti ka sjellë dhe reflektime të pasqyruara në hapjen e programeve të reja në Master.</p> <p>Studimi është kryer mbi punësimin e studentëve, që janë diplomuar në programet Bachelor dhe Master (shkencor dhe profesional), të cilat ofrohen nga Departamenti i Sociologjisë nga viti akademik 2018-2019 deri në vitin akademik 2020-2021. Ai është ndarë në pesë kapituj, ku përfshin aspektin teorik, raportin aplikime-pranime në Departamentin e Sociologjisë në ciklin e parë dhe të dytë, si dhe analizën e bazuar të pyetësorët me të diplomuarit e viteve 2018-2021, ku përfshihet shpërndarja gjeografike e tyre, punësimi dhe sektori i punësimit. Më pas jepen të dhëna mbi përshtatjen e aftësive me kërkesat e tregut, përfundime dhe rekomandime. 67 % e të anketuarve janë përgjigjur se studimet në Sociologji i kanë ndihmuar në punësimin e tyre, ku 63.6 % e totalit të të pyeturve kanë deklaruar se janë punësuar me kohë të plotë, ndërsa 24.4 % me kohë të pjesshme. Numri i të anketuarve ishte gjithsej 183 të diplomuar.</p> <p><i>[Ref: Propozim i Departamentit Sociologji-Filozofi- Shkenca Politike për diplomë të nivelit të parë në Sociologji, evidenca 3.4.1; Studimi i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve. Hyrje, evidenca 3.31.]</i></p>

<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Sociologji, si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave, që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p><i>[Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2.; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, Prioriteti strategjik 1 dhe prioriteti strategjik 4, evidenca 3.5; Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’, Pika 3. Objektivat e Programit të studimit dhe Rezultatet e pritshme, evidenca 4.1].</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Sociologji ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, të cilët kanë gjithashtu përvojën dhe burimet akademike në fushën e sociologjisë. Departamenti i Sociologjisë, në vitin aktual akademik 2021-2022, ka të angazhuar 10 lektorë me kohë të plotë, me grada e tituj shkencorë (1) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc.; (7) Dr.; (1) Dr. në proces, të cilët ofrojnë kapacitetet profesionale të mësimdhënies në programin e studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Në këtë program studimi janë të angazhuar gjithashtu edhe personel akademik efektiv i njësisë të tjera bazë të UT, të cilët ofrojnë kapacitetet e tyre në funksion të mësimdhënies kryesisht në veprimtari formuese ndërdisiplinare dhe të përgjithshme.</p> <p>Përvoja e stafit akademik dhe kërkimi i tyre shkencor, bazuar në të dhënat e siguruar nga institucioni, vizita në IAL dhe RVB janë dëshmi e kapaciteteve akademike që Departamenti i Sociologjisë ofron për përmbushjen e qëllimit të ofrimit të ciklit të studimeve “Bachelor” në Sociologji.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 1.2.; Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), pika 5 Personeli dhe infrastruktura, evidenca 1.4.; Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2), evidenca 4.12; Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës sipas programit të studimit (Tabelat 12) “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 4.5; Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit BACHELOR në</i></p>

	<p>“SOCIOLOGJI”, (Tabelat 6), evidenca 4.7; Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7), evidenca 4.13; Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit, evidenca 4.11; CV të personelit akademik të programit të studimit për 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, evidenca 4.15.]</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe gjatë vizitës në institucion konstatoi se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit Bachelor në Sociologji është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, që është Fakulteti i Shkencave Sociale, si dhe i shërben misionit të tij. Gjithashtu programi në fjalë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Sociologjisë dhe në shërbim të misionit të tij.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Sociologji është në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Evropiane dhe Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale. Pjesa III. Organizimi, Struktura, Elementët e Studimeve, evidenca 2.4.; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” Pjesa III. Organizimi i Studimeve, evidenca 3.6.; Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’. Pika 2, Parimet dhe kërkesat e Programit; Pika 4. Struktura dhe karakteristikat e Programit të studimeve, evidenca 4.1; Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), evidenca 1.4; Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë (2020-2024). Prioriteti Strategjik: Mësimdhënia dhe zhvillimi i kurrikulës. Objektiva 7 dhe 8. Prioriteti strategjik: Ndërkombëtarizimi, evidenca 3.2.; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024. Prioriteti strategjik: Zhvillimi i kurrikulës. Objektivi 3 dhe 4. Prioriteti strategjik: Ndërkombëtarizimi, evidenca 3.5].</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin përkatës, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit “Bachelor” në “Sociologji” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Bazuar te kurrikula e programit, syllabuset e lëndëve, CV-të e stafit mësimdhënës si dhe veprimtaria kërkimore e shkencore e realizuar në kuadër të programit, evidentohet, si në fushën akademike, ashtu edhe kërkimore, orientimi i zhvillimit të programit në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e njësisë bazë në fushën e studimeve sociologjike.</p> <p>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’. Pika 3. Objektivat e Programit të studimit dhe Rezultatet e pritshme, evidenca 4.1; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 3.6; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, neni 6, evidenca 3.3.].</p>
	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>Përmbushet kryesisht</p> <p>Përmbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit

X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se ka ndarje e zbatim të detyrave, të përcaktuara edhe me rregullore, të njërive e personelit lidhur me organizimin e mbarëvajtjen e programit të studimit.

Bazuar dhe në intervistat e zhvilluara në IAL, u vërejt se analiza e vazhdueshme e punës së strukturave realizohet nëpërmjet treguesve të matshëm të realizimit të detyrave në formën e raportimeve tek drejtuesit e Departamentit ose Dekani, nëpërmjet takimeve periodike me titullarët, si dhe vlerësimit të performancës së pedagogut nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe përgjegjësve të njërive të personelit.

Bazuar dhe në dokumentacion dhe RVB, rezulton se Departamenti i Sociologjisë bashkëpunon me Fakultetin e Shkencave Sociale, si dhe Departamentin e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Departamentin e Punës Sociale, Departamentin e Shkencave Politike dhe Departamentin e Filozofisë. Krahas FSHS, departamenti bashkëpunon dhe me Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Filologji – Historisë, si dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Nga shqyrtimi i dokumenteve në dispozicion të GVJ, rezulton se njësitë bazë e përgjegjëse kanë të dokumentuar gjithashtu procedurat dhe analizat e vazhdueshme të punës së tyre.

[Ref: Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.18; Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.23; Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale, evidenca 2.18].

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.

Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, IAL garanton cilësinë dhe ligjshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që kontribuojnë në rritjen akademike të institucionit në përgjithësi dhe zhvillimin e profesionalizmit të stafit pedagogjik, duke siguruar në veçanti realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.

Në funksion të realizimit të programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji”, rezulton se janë nënshkruar marrëveshje me mbi 50 institucione, si Agjencia e Rinisë, Qendra Komunitare Multidisiplinare, Bashkia e Tiranës, Kukësit, Lezhës, Elbasanit, Sarandës, Mirditës, Peshkopisë e disa organizata të tjera e përfaqësuese të shoqërisë civile.

Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit janë organizuar edhe konferenca në bashkëpunim me partnerët homologë të universiteteve

	<p>publike, në të cilat janë angazhuar edhe studentë të ciklit Bachelor në Sociologji.</p> <p><i>[Ref: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.21; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.18].</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni përkatës, rezultojnë se institucioni e konsideron objektiv strategjik zgjerimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë harton në mënyrë periodike relacione të veçanta për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për secilin aktivitet të zhvilluar në institucion me bashkëpunëtorët ose homologët në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>[Ref: Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, evidenca 3.19; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 3.18; Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.21].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Bazuar në tabelën përmbledhëse të institucioneve me të cilat IAL ka bashkëpunim, rezultojnë se Fakulteti i Shkencave Sociale është në mbështetje të zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucione të tjera, si dhe bazuar dhe në intervistat e zhvilluara, IAL është në kërkim për kontakte të reja, duke hartuar politika për instalimin e bashkëpunimit. Institucioni në ka realizuar marrëveshje me institucione shtetërore sociale dhe arsimore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së praktikës së studentëve të programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji”.</p> <p><i>[Ref: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.21; Manuali i praktikës profesionale, evidenca 4.4].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe intervistat e kryera, konstatohet se IAL në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore ka organizuar disa trajnime në bashkërendim me punëdhënësit ose drejtuesit e disa shoqatave në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shërbejnë për ngritjen profesionale, kryesisht të studentëve të diplomuar. Trajnimet janë të natyrës objektive dhe praktike, kanë karakter aplikativ dhe i përgatisin studentët për karrierën e tyre në të ardhmen.</p>

	<p>Një kujdes i veçantë i është kushtuar kontakteve me rrjetin Alumni, si dhe ofrimin ndaj tyre të mundësive të reja të zhvillim pas studimeve në bashkëpunim me institucione të ndryshme. Departamenti i Sociologjisë njofton të diplomuarit për mundësitë e trajnimeve nëpërmjet faqes Alumni Bachelor në “Sociologji”: https://www.facebook.com/AlumnibachelorsociologjiUT <i>[Ref: Tabela përmbledhëse për trajnime dhe pjesëmarrje në programe kualifikimi, konferenca etj., evidenca 3.21.1].</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, rezulton se ky program studimi, me kohë të plotë është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi realizohet në formën e studimeve me kohë të plotë dhe përfundon me marrjen e diplomës. Siç është përcaktuar edhe në dokumentin mbi misionin dhe objektivat e programit, organizimi i tij “realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Ato realizohen në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.</p> <p>IAL në zbatim të kërkesave të Marrëveshjes së Bolonjës, që nga viti 2005 filloi formësimin e studimeve të ciklit të parë Sociologji dhe me vendim nr. 831, datë 04.06.2008 vendosi hapjen e programit të ciklit të parë të studimeve në Sociologji.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji” ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>[Ref: Vendimi Nr. 831, datë 04.06.2008 “Për hapjen dhe mbylljen e disa programeve të studimit, të Ciklit të Parë në Universitetin e Tiranës, për</i></p>

	<p>vitin akademik 2008-2009”, evidenca 3.4; Korniza konceptuale e programit të Studimit “Bachelor në Sociologji”, Pika 1. Përshkrim përmbledhës i programit të studimeve. Pika 2 Parimet dhe kërkesat e Programit, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Në dokumentacionin përkatës të programit, përcaktohet si objektivi kryesor i tij synimi të përgatisë sociologë me kulturë të gjerë sociologjike të nivelit universitar të ciklit të parë, ku në përfundim të studimeve, të mund të konkurrojnë në tregun e punës për t’u përgatitur si specialistë, këshilltarë, drejtues projektsh, mësues, etj. Realizimi i programit të studimit, bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese, si dhe ato të natyrës praktike. Studentët që do t’i nënshtrohen këtij programi studimi do të kenë njohuri të konsoliduara në fushën e sociologjisë.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji” dhe në informacionin e dalë nga studimi i tregut, rezultojnë se programi ofron mundësi, që studentët të ndërmarrin praktika në subjekte publike dhe jopublike. Nga intervistat e zhvilluara me pedagogët dhe studentët, rezultojnë se stafi akademik i përfshirë në këtë program kombinon të mësuarit me veprimtari shkollore dhe punë, bazuar në konsulencën dhe praktikën profesionale.</p> <p>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’. Pika 4. Struktura dhe karakteristikat e Programit të studimeve, evidenca 4.1; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, prioriteti strategjik 1-5, evidenca 3.5; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Sipas RVB dhe rregullores së programit Bachelor në “Sociologji”, planet mësimore e syllabuset e lëndëve, si dhe nga biseda me stafin akademik dhe studentët e diplomuar, rezultojnë se ky program synon të japë një qasje të zgjeruar dhe të specializuar të koncepteve e çështjeve themelore në fushën e sociologjisë, si dhe fusha të tjera të lidhura me to e të përcaktuara në program.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Sociologji ka si mision të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të formuar specialistë në fushën e sociologjisë, të aftë të konkurojnë në treg, si dhe të përballen me kërkesat në rritje të tregut të punës. Programi ka si qëllim gjithashtu të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve të mendimit sociologjik, duke i përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e saj me anë të promovimit të aftësive të mendimit kritik në probleme me interes publik.</p> <p>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’. Pika 4. Struktura dhe karakteristikat e Programit të</p>

	<p><i>studimeve, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët e këtij programi, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, evidentohet se programi përfshin në kurrikulën e vet lëndë, ku synohet që të diplomuarit të kenë një formim kulturor, shkencor dhe profesional në nivele të përparuara. Kompetencat e programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” lidhen me aftësimin e të diplomuarit për të ofruar shërbime profesionale. Programi gjithashtu ndihmon dhe siguron, që studentët të marrin njohuri dhe kompetenca bazuar në nxënien në auditorë dhe në punën praktike, si dhe rrit aftësitë krijuese dhe aplikative tek ta. Krahas këtyre, programi ofron mundësinë, që studentët të ndërmarrin praktika në subjekte publike dhe jopublike.</p> <p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program kombinon të nxënit me veprimtari dhe punë, bazuar në konsulencën dhe praktikën profesionale. Nga intervistat me studentët rezulton se pedagogët ofrojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e tyre akademik.</p> <p><i>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’’. Pika 4. Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1].</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin përkatës dhe syllabuset e lëndëve, programi i ciklit të parë në “Sociologji” i përmban të gjitha elementët, që përbëjnë strukturën e programit të studimit. Rregullorja mësimore e programit mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” e në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Struktura e studimeve për programin “Sociologji” përfshin: proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit dhe janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar, i cili vlerësohet nga një komision i ngritur për të. Disiplinat që zhvillohen në programin e Sociologjisë janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese. Lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur.</p> <p>Viti akademik zgjat 30 javë mësimore, i ndarë në dy semestra. Me përfundimin e këtij programi studimi, Fakulteti i Shkencave Sociale lëshon diplomë “Bachelor” në “Sociologji”, të shoqëruar me suplementin e diplomës, referuar niveli 6 të “Kornizës Shqiptare të Kualifikimit”.</p>

	[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit 'Bachelor në Sociologji', evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1].		
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit e syllabuseve të lëndëve rezultojnë se në strukturën e programit janë të qarta ndarjet e veprimtarive formuese, që ofrohen në këtë program studimi. Ato grupohen në kategoritë e përcaktuara të veprimtarive formuese, si: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese e detyrimit përmbyllëse, me ngarkesën përkatëse në kredite, bazuar tek VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Gjithashtu, programet specifike të çdo lënde janë në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim dhe përfshijnë: pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin si dhe adresën elektronike të pedagogut. Në vazhdim janë: zëri i përmbledhjes dhe rezultatit të të nxëniet, konceptet themelore, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura si dhe zëri i vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Klasifikimi në programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji” sipas komponentëve mësimorë është:</p> <p>A. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 7 lëndë, ose 19.5 % të planit mësimor;</p> <p>B. Për përgatitjen Përgatitje për disiplinën shkencore – 21 lëndë , ose 53.4 % e planit mësimor;</p> <p>C. Në lëndët ndërdisiplinore/integruese, përfshihen nëndisiplina dhe lende me zgjedhje - 6 lëndë, ose 13.8% te planit;</p> <p>D. Lëndët plotësuese përfshijnë 4 lëndë të planit, ose 10% të tij.</p> <p>E. Lëndët përmbyllëse (provim/diplomë), 3.3 % të planit mësimor.</p> <p>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit 'Bachelor në Sociologji', Pika 4. Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Referuar dokumentacionit të institucionit dhe RVB, konstatohet se Departamenti i Sociologjisë, përgjegjës për programin e ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti, bashkërendon dhe administron veprimtaritë akademike, kërkimore dhe shkencore në respekt të lirisë akademike të stafit mësimdhënës.</p>

	<p>Bazuar verifikimeve të kryera nga RVJ, rezulton se NJSBC bashkëpunon me departamentin për përmbushjen e veprimtarisë vlerësuese dhe hartimit të raporteve për cilësinë e programit të studimit.</p> <p>Me propozim të njësisë bazë, ngrihen grupet e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit, të cilat miratohen dhe shpallen me vendim nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu X, neni 141, evidenca 1.2; Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS (NJSBC), evidenca 2.14; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Kreu X, Neni 36, evidenca 3.6; Vendimi për ngritjen e grupeve të vlerësimit të brendshëm nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale, evidenca 2.17].</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” caktohet koordinatori i programit, i cili mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, që mbulon për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivat e programit.</p> <p>Sipas RVB dhe intervistave të zhvilluara, njësia kryesore ka përcaktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, ku janë të miratuara dhe përcaktuara të gjitha detyrat në përputhje me objektivat e programit. Koordinatori është përgjegjës për zhvillimin e programit dhe praktikave mësimore.</p> <p>Në analizën vjetore dhe mbledhjet e departamentit, raportohet për mbarëvajtjen e programit dhe të punës së tij, duke u ndalur në problemet që lidhen me stafin akademik, kurrikulën e mësimdhënies, shërbimet mësimore-studentore, administrimin, vlerësimin, programet akademike dhe kërkimore.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” Neni 4.2. Koordinatori i programit, evidenca 3.6; Vendim i datës 17.09.2019. “Për caktimin e koordinatorit të programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 3.11; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 4.2.2, evidenca 3.6].</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se, si njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Sociale, ashtu edhe njësia bazë, pjesë e strukturës së tij, Departamenti i Sociologjisë, që ofron programin “Bachelor” në “Sociologji”, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti në fjalë funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe e punës kërkimore-shkencore të Fakultetit; ai nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore edhe lidhur me programin në fjalë.</p> <p>Departamenti mbledhet të paktën një herë në muaj, duke kryer funksionet e tij, përmbush kërkesat dhe standardet e cilësisë për organizimin e programit nga pikëpamja infrastrukturore dhe nevojat kryesore për strukturën akademike dhe për kualifikimet e stafit akademik.</p> <p>Departamenti krahas stafit akademik ka në përbërje edhe personel administrativ, që administron dhe mirëmban dokumentacionin arsimor.</p>

	<p>Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukture të tij. Ai propozon edhe kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë e akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit, si dhe të Fakultetit përkatës të Shkencave Sociale.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, evidenca 1.2; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, evidenca 3.3; Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit; Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (2018-2021), evidenca 4.6; intervista me drejtues dhe anëtarë të stafit akademik të departamentit].</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë, si njësi përgjegjëse për programin “Bachelor” në “Sociologji” përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në përbërje të tij janë 10 lektorë me kohë të plotë, me grada e tituj shkencorë (1) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc.; (7) Dr. dhe (1) Dr. në proces. Lektorët mbulojnë lëndë në përputhje me kualifikimet dhe interesat e tyre të kërkimit shkencor.</p> <p>Departamenti përcakton kriteret dhe nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, si dhe i propozon dekanit të fakultetit kandidaturat për personel akademik me kohë të plotë, sipas listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 74, pika 2, 3, evidenca 1.2; Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit BACHELOR në “SOCIOLOGJI”, (Tabelat 6), evidenca 4.7; Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7), evidenca 4.13; Vendimit Nr. 418, datë 10.5.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, evidenca II.2.4; Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabelat 12) programi i studimit “Bachelor” në “Sociologji, evidenca 4.5; Të dhëna sipas moshës për stafin akademik në vitin e fundit (Tabela 8), evidenca 4.13.1; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale. Neni 23, evidenca 2.4; Veprimtaria kërkimore në nivel programi “Bachelor” në “Sociologji” (2018-2021), evidenca 4.6].</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstaton se njësi kryesore, Fakulteti i Shkencave Sociale, i përmbahet kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë, ku struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin, rregulloren dhe aktet e tjera të institucionit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Departamenti i Sociologjisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ka 10 anëtarë efektivë, si dhe personel përkatës administrativ. Departamenti, për realizimin e procesit mësimor ka gjithashtu në funksion</p>

	<p>të veprimtarisë mësimdhënëse edhe 25 anëtarë me kohë të pjesshme, duke mbuluar të gjitha nevojat për çdo lëndët dhe kurset e programit.</p> <p>Përgjegjësitë dhe kompetencat e departamentit janë të përcaktuara në aktet dhe rregulloren e brendshme të UT dhe Rregulloren e FSHS në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë.</p> <p>Njësia bazë koordinon punën më njësinë përgjegjëse për të përmbushur detyrimet e organizimit të strukturës akademike.</p> <p><i>[Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, evidenca 2.4; Organigrama e struktura e FSHS-së, evidenca 2.5; Struktura mësimore përgjatë një viti akademik, evidenca 2.6.1; Model marrëveshjeje vjetore për shpërndarjen e ngarkesës së punës me personelin akademik, evidenca 2.21].</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin në dispozicion, institucioni disponon informacionet e nevojshme mbi programin e studimit, strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e saj. Rregullorja e fakultetit, departamentit dhe e programit të studimit, misioni e plani strategjik për programin, rregullorja e diplomimit, planet mësimore me syllabuset përkatëse të lëndëve, marrëveshjet me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese e partnerët, rregullorja e provimeve, transferimeve, praktikës, informacionet për trajnimet e studentëve e aktivitetet ekstrakurrikulare, si dhe mundësitë e orientimit dhe këshillimit për karriere, etj. janë pjesë e dokumentacionit që disponon departamenti, i cili është përgjegjës në organizimin e strukturës dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Njësia disponon gjithashtu informacione nëpërmjet ngarkesës mësimore, planit të punës dhe programin e aktiviteteve të programit “Bachelor” në “Sociologji”.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, programi “Bachelor” në “Sociologji” është organizuar në veprimtari formuese, të grupuara në lëndë bazë të programit të studimit, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, praktikë profesionale e detyrime përmbyllëse. Disiplinat grupohen mbi bazën e objektivave të tyre formuese, duke respektuar raportet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Sipas rregullores së programit, veprimtaritë formuese realizohen nëpërmjet mësimit në auditor (leksione, seminare, ushtrime),
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike	

<p>të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>studimit individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, përgatitje e punimit të diplomës/provim formimi) dhe praktika profesionale. Në planin mësimor të programit përcaktohen lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, në vite e semestra, me kreditet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Klasifikimi sipas komponentëve mësimorë për programin “Bachelor në Sociologji” është: F. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 7 lëndë, ose 19.5 % të planit mësimor; G. Për përgatitjen Përgatitje për disiplinën shkencore – 21 lëndë, ose 53.4 % e planit mësimor;</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>H. Në lëndët ndërdisiplinore/integruese, përfshihen nëndisiplina dhe lende me zgjedhje - 6 lëndë, ose 13.8% te planit; I. Lëndët plotësuese përfshijnë 4 lëndë të planit, ose 10% të tij. J. Lëndët përbyllëse (provim/diplomë), 3.3 % të planit mësimor. Lëndët dhe modulet e programit janë të vlerësuara më kredite, sipas sistemit vendas dhe evropian, të ndara në 6 semestra me kohëzgjatjen 3 vjeçare e që plotësojnë numrin total të 180 krediteve evropiane (ECTS). Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite dhe 1.500 orë mësimore. Nga shqyrtimi i rregullores e planit mësimor të programit Bachelor” në “Sociologji”, GVJ vëren se në to përmbahet informacioni i duhur për ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit. Programi mësimor i lëndës, jep në formë të përmbledhur strukturën e lëndës; përmbajtjen, orët përkatëse në auditor, duke i specifikuar në leksione dhe seminare, njohuritë paraprake të nevojshme për ndjekjen e lëndës, kushtet e veçanta në lidhje me frekuentimin dhe shlyerjen e detyrimeve para formës përfundimtare të vlerësimit. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës e miratohet, pasi konsultohet në departament. Studentët mund të marrin gjithashtu të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të tyre. Formati i syllabusit të lëndës dokumenton në mënyrë të detajuar informacionin mbi rezultatet e pritshme të të nxënit në përputhje me formatet e miratuara, sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe ndryshimet përkatëse. GVJ konstaton gjithashtu se rregullorja e programit të studimit parashikon rishikim në mënyrë periodike të programit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm. Para fillimit të vitit të ri akademik bëhet po ashtu rishikimi i programeve, ku synohet të korrigjohen problemet, që janë ndeshur gjatë procesit mësimor, duke përmirësuar dhe përditësuar elementë të ndryshëm të programit.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale. Pjesa III., evidenca 2.4; Organizmi, Struktura, Elementet e Studimeve, evidenca 2.4; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, KREU II. Organizimi dhe drejtimi i programit të studimit, evidenca 3.6, Neni 10-</i></p>

	<p>15, Kreu IV: Vlerësimi i studentëve; Korniza konceptuale e programit të Studimit ‘Bachelor në Sociologji’, pika 4, 5 dhe 6, Struktura dhe karakteristikat e Programit të studimeve, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, evidenca 4.3; Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2; Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 1; neni 47 pika m; neni 109, neni 112, evidenca 1.2; Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2016 e përditësuar, pjesa III. Organizimi, struktura, elementet e studimeve, pjesa III, nenet 33- 41 dhe kreu III, evidenca 1.3;</p> <p>Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13), evidenca 4.14; Procedura e transferimit të studentit E. F. Nga një IAL jo publike, evidenca 4.9; Procedura e ekuivalentimit nga programet e mobilitetit të studentit K. L., evidenca 3.30.1;</p> <p>Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave, evidenca 2.15; Procedura e ndjekur për ndryshimin e kurrikulës së programit të studimit, evidenca 3.15; Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 11), evidenca 4.2.3].</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ referuar dokumenteve të dorëzuar konstaton se ngarkesa e programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, ku programi është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 180 ECTS; - 6 semestra, 2 në çdo vit. <p>Plani mësimor i programit është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Rregulloren e posaçme të programit dhe Kalendarin Akademik të IAL. Organizimi i programit realizohet nëpërmjet moduleve dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Një kredit universitar përkon deri me 25 orë pune të studentit, përfshirë këtu dhe kohën për studim individual. Ngarkesa vjetore e punës së një studenti me kohë të plotë është 60 kredite. Programi i studimit “Bachelor” në “Sociologji” realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike. Në përlllogaritjen e orëve të kreditit përfshihen edhe koha për</p>

	<p>përgatitje dhe punë të pavarur të studentit. Ngarkesa e përgjithshme vjetore është jo më pak se 1500 orë.</p> <p>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, neni 15 neni 16, evidenca 2.4; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Neni 8 Përgjegjësitë e Drejtuesit të Departamentit, evidenca 3.3; Ngarkesa totale e personelit akademik të programit “Bachelor” në “Sociologji” në një vit akademik (Tabela 4), evidenca 4.5.1; Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13), evidenca 4.14].</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, emërtimi e përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë njohuri dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Struktura e studimeve për programin “Bachelor” në “Sociologji” përfshin: proces mësimor, praktikë profesionale, përgatitje e punimit të diplomës/apo provimit të përgjithshëm përfundimtar. Format e punës mësimore janë parashikuar në planin mësimor të programit. Ato janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testet, provimet semestrale dhe mbrojtja e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Disiplinat që zhvillohen në programin “Sociologji” janë disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese të programit të studimit, disiplina të ngjashme/integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese, disiplina me zgjedhje nga studenti të disiplinave të ofruara prej institucionit dhe njohuri të tjera formuese. Në tre vitet akademike janë bërë riororganizime në përmbajtjen e lëndëve në përputhje me VKM 41, ku organizimi i lëndëve është bërë në veprimtari nga A-E, miratuar nga Senati i UT.</p> <p>[Ref: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikrat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.2.1].</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se shpërndarja e lëndëve në vite e semestra, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Objektivat formues të programit “Bachelor” në “Sociologji” janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i program mësimor konkurrues bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurríkula bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit; - Kultivimi i imagjinatës sociologjike; - Puna në grup për të përmirësuar kushtet shoqërore; - Promovimi i aftësisë së mendimit kritik; <p>Oferta akademike e studimeve në këtë program studimi është konceptuar për të formuar qytetarë të pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këndvështrim objektiv dhe kritik në shoqërisë;

	<p>- Aftësi dhe kapacitete për të ndikuar zhvillimet shoqërore dhe ato të politikave të ndryshme.</p> <p>- Metodatat për të kuptuar mjedisin shoqëror në disa nivele të ndryshme.</p> <p>Studentët, që do të jenë pjesë e këtij programi studimi do të kenë njohuri në fushën e kërkimit sociologjik; dije të përgjithshme të domosdoshme nga disiplina ekonomike, historike dhe psikologjike; dije të specializuara teorike dhe analitike në nëndegëzime të shkencës së sociologjisë si: sociologji familje, sociologji rurale, sociologji gjinore, sociologji kulture, sociologji feje, sociologji komunikimi, sociologji urbane, sociologji migrimi, sociologji deviance, sociologji e njohjes, sociologji edukimi, sociologji shëndeti, sociologji pune, etj.</p> <p>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit “Bachelor në Sociologji”, pika 3, evidenca 3.21].</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, se kurrikula e programit, syllabusët dhe planet mësimore të tre viteve, struktura e tij, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite dhe raporti teori praktikë janë hartuar bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca nr. 1, Tab. nr. 1, i ndryshuar. Ato janë në përputhje e me synim të realizimit të objektivave të programit.</p> <p>Të gjitha lëndët janë të pajisura me tekste përkatëse origjinale, të përkthyer ose leksione të përgatitura nga pedagogu i lëndës, ku studentët gjejnë parashtrimet themelore për lëndën. Përpos teksteve, studentëve iu referohet literaturë plotësuese.</p> <p>[Ref: Procedura e ekuivalentimit nga programet e mobilitetit të studentit K. L, evidenca 3.30.1; Program mobiliteti të studentit të huaj M. V., evidenca 3.30; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, evidenca 3.5; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1].</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës mbi programin, rezulton se organizimi i tij sipas llojit të veprimtarive formuese (A, B, C, D, E) me lëndët bazë të formimit të përgjithshëm e përgatitjes metodologjike, lëndët e formimit specifik, ndërdisiplinore e integruese; të veprimtarisë praktike e detyrimeve përmbyllëse etj. dhe përcaktimi i raporteve midis formimit teorik dhe praktik i shërben arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve, mobilitetit dhe punësimit në përfundim të studimeve. Vendosija në kurrikulën e programit të disa lëndëve dhe nga shkencat e tjera shoqërore u shërben objektivave më të gjëra të programit për studimin e sociologjisë me shkencat e tjera sociale.</p> <p>[Ref: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9), evidenca 4.2.2; Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në Sociologji, neni 13, evidenca 3.6; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 13, evidenca 3.6; Manuali i praktikës së studimeve “Bachelor: në “Sociologji”, evidenca 4.4; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 14, evidenca 3.6; Institucionet dhe</p>

	<i>Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikant profesional me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.21].</i>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, vizita në Bibliotekën e Fakultetit e biseda me stafin pedagogjik të programit, GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen për gjatë tre viteve akademike në programin Bachelor në “Sociologji” bazohen në literaturë të detyruar e ndihmëse edhe të viteve të fundit. Vetë institucioni disponon një bibliotekë në shërbim të programit, ku krahas librave sociologjikë gjenden dhe një pjesë e tezave të doktoraturave ndër vite mbrojtur në departament.</p> <p>Në tërësi, përmbajtja e lëndëve dhe syllabuset përditësohen, si një kusht i detyruar i vënë nga departamenti, duke u azhurnuar edhe me tendencat e qasjeve moderne e shkencore në sociologji.</p> <p>Në programin e studimit “Bachelor” në “Sociologji”, programet lëndore miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani dhe dorëzohen në departament.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 11, evidenca 3.6; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3].</i></p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Nga biseda me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik të programit dhe studentët, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit “Bachelor” në “Sociologji” garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Kjo del në pah nga shqyrtimi i organizimit të kurrikulës, përmbajtjes së lëndëve, literaturës, programit të praktikës e aktiviteteve të tjera kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që shoqërojnë formimin e përgatitjen e studentëve përgjatë tre viteve akademike.</p> <p><i>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit “Bachelor në Sociologji”, evidenca 4.1; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022, evidenca 4.2.1].</i></p>
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Nga takimet me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit të Sociologjisë, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se programi është konceptuar i organizuar për të mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës si në administratën lokale, ashtu dhe atë kombëtare, si dhe organizata të ndryshme joqeveritare.</p> <p>Studentët nëpërmjet këtij programi fitojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme lidhur me zgjidhjen e problemeve sociale në shoqërinë e sotme. Zhvillimet e reja në tregun e punës kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mësimore me aftësitë, që kërkon tregu i punës.</p> <p>Për rrjedhojë në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, institucioni ka zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktiviteteve konsultative, duke filluar që nga tryezat e rumbullakëta me specialistë të fushës. Në të njëjtën kohë njësia</p>
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	

	<p>bazë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut.</p> <p>Nga biseda e GVJ me drejtuesit e departamentit e stafin pedagogjik, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit është në vëmendjen dhe objektivat e departamentit, duke përfshirë edhe rrjetin Alumni.</p> <p><i>[Ref: Korniza konceptuale e programit të Studimit “Bachelor në Sociologji”, evidenca 4.1; Strategjia e zhvillimit të programit “Bachelor” në “Sociologji”, 2020-2024, evidenca 3.5; Studimi i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve, evidenca 3.31; Tabela përmbledhëse për trajnime dhe pjesëmarrje në programe kualifikimi, konferenca për te diplomuarit, evidenca 3.21.1; Dosje e leksioneve/ aktiviteteve/ konferencave të hapura: “Shqyrtime sociologjike të sfidave të arsimimit universitar në shoqërinë shqiptare” organizuar nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, Tiranë, Shqipëri nëntor 2019, evidenca 3.24; Procedura e ndryshimit të kurrikulës: diskutimi në departament, përcjellja e ndryshimeve, plani i firmosur, propozimi, vendimi i senatit, evidenca 3.15; Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, evidenca 3.19].</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të veprimtarisë kërkimore - shkencore e botuese të personelit akademik, i angazhuar në realizimin e programit “Bachelor” në “Sociologji”, rezulton se, si personeli akademik me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kohë të pjesshme, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie personel të kualifikuar me tituj dhe grada shkencore, profesorë me përvojë akademike, duke aplikuar edhe modulet me lektorë të ftuar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë, ka në përbërjen e tij 10 lektorë me kohë të plotë PAE, me grada e tituj shkencorë (1) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc.; (7) Dr.; (1) Dr. në proces, si dhe 25 me kohë të pjesshme PAK, të cilët ofrojnë kapacitetet profesionale të mësimdhënies në programin e studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Personeli PAE e mbulon ngarkesën mësimore të orëve në masën 70 %, sipas udhëzimeve përkatëse të ligjit.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 67, neni 68, evidenca 1.2; Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2016 e përditësuar, Neni 25, evidenca 1.3; Vendim departamenti për kritere punësimi, evidenca 3.17; Manuali për punësimin e personelit në UT, evidenca 1.12; Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli</i></p>

	<p><i>ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2), evidenca 4.12;. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit BACHELOR në "SOCIOLOGJI", (Tabelat 6), evidenca 4.7; Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabelat 12) programi i studimit "Bachelor" në "Sociologji", evidenca 4.5].</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se, bazuar në shqyrtimin e CV-ve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, diploma, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike, përvoja e niveli i kualifikimit, veprimtaria shkencore, si dhe botuese e mëparshme dhe përgjatë zhvillimit të programit, janë në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Përveç personelit të kualifikuar me kohë të plotë, departamenti ka aktivizuar për programin dhe lektorë me kohë të pjeshme dhe lektorë të departamenteve të tjera.</p> <p><i>[Ref: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabelat 12) programi i studimit "Bachelor" në "Sociologji", evidenca 4.5; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë për vitin akademik 2020-2021, 2019-2020, 2018-2019, evidenca 3.18; Veprimtaria kërkimore në nivel programi "Bachelor" në "Sociologji" (2018-2021), evidenca 4.6; Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit, evidenca 4.11; CV të personelit akademik të programit të studimit për 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021; 2021-2022, evidenca 4.15].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga takimet me përgjegjësën e departamentit, stafin akademik e studentët e regjistruar në programin Bachelor në Sociologji, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se për orientimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale, punimit të diplomës etj., është caktuar një staf i duhur akademik, me kualifikimin përkatës. Specifikisht Departamenti i Sociologjisë në bashkëpunim me njësinë kërkimore shkencore të fakultetit, promovon kërkime e studime krahasuese të pedagogëve dhe studentëve në fushat e sociologjisë.</p> <p>Bazuar në RVB dhe intervistat e zhvilluara, Departamenti është angazhuar në rrjetin e bashkëpunimit akademik e kërkimor me pedagogë e studentë të Institucioneve Arsimore të Larta homologe. Kjo është konkretizuar me organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin dhe zgjerimin dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe të rejtat shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p><i>[Ref: Veprimtaria kërkimore në nivel programi "Bachelor" në "Sociologji" (2018-2021), pika VIII, evidenca 4.6; Rregullore për diplomat e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Sociologji, Neni 2, evidenca 3.6.1; Manuali i praktikës profesionale, Lista e institucioneve bashkëpunuese, evidenca 4.4; Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, evidenca 3.19].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin përkatës, si dhe nga vizita e GVJ në mjediset e institucionit, rezulton se në shërbim të veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, si dhe në mbështetje të realizimit të</p>

përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	programit “Bachelor” në “Sociologji”, Fakulteti i Shkencave Sociale ka një infrastrukturë efektive në shërbim të mbarëvajtjes së programeve që ofrohen. [Ref: Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësi Bazë, evidenca 2.33; Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17), evidenca 2.30.1].		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriterët	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e institucionit, të njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që ofron programin në shqyrtim, GVJ konstaton se, që në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Planit Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit, Strategjisë së Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë, Strategjisë së Zhvillimit të Programit “Bachelor” në “Sociologji” dhe Politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, përcaktohen si prioritet strategjik zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, si një element i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike në çdo program studimi, që zhvillohet në njësitë bazë të UT. Universiteti i Tiranës ofron vazhdimisht trajnime, të cilat ofrohen nga qendra virtuale e zhvillimit profesional dhe trajnimit: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnim-it-dhe-zhvillimit-profesional/ [Ref: Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), evidenca 1.4; Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, evidenca 2.3; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, evidenca 3.5; Strategjia e zhvillimit të Departamentit, evidenca 3.2; Politika të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, evidenca 3.22].

	<p>https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnim-it-dhe-zhvillimit-profesional/</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, RVJ konstaton se në institucion dhe në njësitë përgjegjëse, funksionojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të procesit mësimor e performancës së personalit akademik dhe ndihmës akademik. Përcaktuar me statut e sipas Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, në rang institucioni funksionon NJSBC për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, e cila si formë të veprimtarisë së saj ka vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, organizimin e pyetësorëve me studentët për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë të programeve të studimit dhe efikasitetin e programeve të ofruara. NJSBC evidenton përmbushjen e detyrave me hartimin e raporteve të vlerësimeve për çdo program studimi, të cilat shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe për vlerësimin e jashtëm.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018, neni 41, evidenca 1.2; Rregullore e NJSC të FSHS 2020, evidenca 2. 14; Paketa e instrumenteve të cilësisë, evidenca 1.14; Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.23].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe intervistat e zhvilluara me drejtues, staf akademik dhe studentë të programit “Bachelor” në “Sociologji”, NJSBC përfshin studentët në vlerësimin periodik në mënyrë anonime nëpërmjet një pyetësori, i cili realizohet çdo semestër dhe në përfundim të mbledhjes së të dhënave bëhet përpunimi i tyre dhe diskutimi i rezultateve.</p> <p>Në lidhje me ankesave për provimet, ato i paraqiten me shkrim përgjegjësit të departamentit. Nëse verifikohet gabimi, përgjegjësi i departamentit në bashkëveprim me komisionin e provimit bëjnë korigjimin. Në rast të pamundësisë së zgjidhjes së ankesës, vihet në dijeni dekani, i cili brenda ngre një komision ad-hoc, që bën verifikimin e pretendimeve të studentit.</p> <p><i>[Ref: Paketa e instrumenteve të cilësisë-pyetësorët e studentëve për lëndëve, evidenca 1.14; Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.23; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.18; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale , neni 49, evidenca 2.4; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 10 dhe neni 20, evidenca 3.6; Informacion për bazën rregullatore të ankimimit të studentëve, evidenca 2.28].</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit përkatës, RVB dhe nga biseda me përfaqësues të NJSBC, drejtuesve dhe stafit akademike, konfirmohet se është në praktikën e punës së institucionit, njësisë përgjegjëse dhe asaj bazë, që rezultatet e procesit të vlerësimit, pasi përpunohen nga struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, u komunikohen autoriteteve drejtuese të institucionit, posaçërisht përgjegjësit të departamentit, i cili ia bën të ditur personelit akademik.</p>

	<p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, 2018, kreu X, evidenca 1.2; Raport periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC), evidenca 2.19; Rregullore e NJSC të FSHS 2020, evidenca 2.14; Përshkrimi i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, evidenca 2.13; Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit, evidenca 2.16].</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në takimet në institucion, si dhe nga dokumentacioni, GVJ vëren se, ndërsa është krijuar një proces institucional vlerësimi për performancën e stafit akademik, kjo nga ana tjetër konsiderohet si procedurë, që ndihmon për të kuptuar edhe shkallën e nevojave dhe përmirësimeve në këtë proces. Drejtuesi u komunikon anëtarëve të stafit, në rrugë personale, të dhënat nga vlerësimi i performancës së tyre në mësimdhënie, mbështetur tek pyetësorët e kryer. Bazuar në procesin e vlerësimit, departamenti promovon shembuj të praktikave të mira, nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, si dhe harton konkluzione dhe rekomandime, të cilat përkthehen në plan masash për të inkurajuar dhe zhvilluar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së pedagogëve.</p> <p>[Ref: Raport periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC), evidenca 2.19; Rregullore e NJSC të FSHS 2020, evidenca 2.14].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, rezulton se institucioni e ka ndërtuar procedurën e format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të dijeve, në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi (VKM Nr.531, datë 24.01.2018). Procesi mësimor është i organizuar me leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, praktika profesionale, teste, provime semestrale dhe mbrojtje e diplomës/provim i përgjithshëm përfundimtar, si dhe workshop-e, seminare dhe konferenca shkencore.</p> <p>[Ref: Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3; Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, evidenca 4.2.1; Plani i miratuar mësimor i programit të studimit, evidenca 4.2; Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura, evidenca 3.24].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi</p>	<p>Bazuar në bisedën me përgjegjësën e njësisë bazë, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit dhe studentë të programit, evidentohet se personeli bën përpjekje t'u përgjigjet nevojave dhe diversitetit të studentëve, si dhe sugjerimeve të tyre lidhur me programin e mësimdhënien. Studentët e programit "Bachelor" në "Sociologji" vijnë nga mjedise shoqërore e kulturore të ndryshme me pritshmëri të larta, ndaj stafi mësimor është përpjekur të realizojë në mënyrë profesionale,</p>

<p>dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>detyrimin dhe me forma, metoda, aktivitete formuese e mundësi alternative mësimdhënieje t'u përgjigjet interesave e këndvështrimeve, si dhe aspiratave të auditorit.</p> <p>Personeli akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies, nxit gjithashtu studentin për të qenë pjesë aktive e procesit mësimor nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive, të cilat shoqërohen nga një përdorim i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit, të cilat ndihmojnë në prezantime më cilësore.</p> <p><i>[Ref: Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni realizon forma të ndryshme në mbështetje të personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike e përdorimin e metodave të reja pedagogjike. Kështu zhvillohen herë pas here nga IAL trajnime të ndryshme, të cilët rrisin performancën akademike dhe didaktike të lektorëve, ku si rezultat i këtyre prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxënësit, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> <p><i>[Ref: Trajnime UT; https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnit-dhe-zhvillimit-profesional/ Trajnime Fakulteti i Shkencave Sociale https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020, evidenca 2.22; Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, evidenca 2.3; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, evidenca 3.5; Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16, Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë, evidenca 2.33].</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me stafin akademik e studente të programit, si edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe angazhimit të tyre përkatës në lëndët e programit të studimit, rezultojnë se titullarët e lëndëve kanë një background të pasur akademik dhe shkencor në fushat e tyre të studimit dhe mësimdhënies, eksperiencë profesionale në metodologjitë e didaktikën mësimore.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie vlerëson profilet e studimit dhe të specializimit të personelit akademik, interesat e tyre mësimore-kërkimore për të realizuar në fillim të çdo viti akademik, si dhe planifikimin e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik, që angazhohet në programin e studimit. Departamenti merr gjithashtu në konsideratë: a) përvojën mësimore dhe kërkimore shkencore në fushën përkatëse; b) publikimet shkencore të realizuara në fushën përkatëse; si dhe c) gradën shkencore/titullin akademik që mban secili lektor.</p>

	<p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 74, evidenca 1.2; Model i Marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik, evidenca 2.21; CV e personelit akademik dhe ndihmësakademik për programin e studimit, evidenca 4.15; Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, (Tabelat 12), evidenca 4.5; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe grupin e studentëve të programit, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezultojnë kujdesi e përpjekja nga ana e institucionit për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë edhe mendimet e sugjerimet e studentëve. Procesi i realizimit të vlerësimit të brendshëm, formë e të cilit janë edhe plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve, ndihmon në analizën, reflektimin dhe përmirësimin nga ana e stafit pedagogjik të cilësisë së mësimdhënies, të didaktikës e metodologjisë së përdorur, literaturës, etj., të lidhur me programin.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga biseda me stafin akademik dhe studentët të programit, evidentohet përpjekja e stafit akademik për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi, që i bëjnë interesante e efektive orët e mësimit.</p> <p>[Ref: Paketa e instrumenteve të cilësisë-pyetësorët për studentët mbi lëndën dhe pedagogun, evidenca 1.14; Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.23; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.18; Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3].</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga biseda me stafin pedagogjik dhe studentët e programit “Bachelor” në “Sociologji”, rezultojnë se ekziston një marrëdhënie pedagog-student, një frymë pozitive e njerëzore komunikimi, si dhe bashkëpunimi në fushën e mësimdhënies. Studentët pohuan përpjekjen nga ana e stafit për të inkurajuar tek ata sensin e autonomisë, diskutimin e lirë, marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikim frytdhënës.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit, orët mësimore në auditor organizohen në orë leksioni dhe seminaresh. Orët e leksionit sikurse reflektohet edhe në planet lëndore janë orë mësimore të drejtuara nga pedagogu në funksion të orientimit të studentëve në kuptim dhe përvetësim të teorive dhe koncepteve lëndore. Bazuar dhe në RVB orët e seminareve inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit për të hulumtuar dhe studiuar literaturë të rekomanduar ose alternative në mënyrë të pavarur jashtë auditorit, në funksion të përgatitjes paraprake për diskutim përgjatë orëve të seminarit.</p> <p>Marrëdhëniet pedagogë-studentë në departamentin e Sociologjisë dhe programin e studimit karakterizohen nga një atmosferë bashkëpunimi e mirëkuptimi në interes të ngritjes në një shkallë sa më të lartë të mësimdhënies, në gjetjen e formave e rrugëve sa më efektive në edukimin e tyre. Personeli akademik vendos për studentët orare konsultimi dhe takimi jashtë orëve mësimore.</p>

	[Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, evidenca 4.3; Orare konsultimi me studentë, evidenca 3.25].		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra e të mirëmbajtura për zhvillimin e procesit mësimor e shkencor. Fakulteti i Shkencave Sociale ka një sipërfaqe të shfrytëzueshme me dy turne mësimore, gjë që sjell dyfishimin e kapaciteteve të fakultetit. Këto mjedise dallohen për nga ndriçimi i bollshëm natyror, sistemi i ftohjes dhe ngrohjes qendrore, që garanton kushte të favorshme për leksion. Nga vizita në institucion vihet re dhe pastërtia, si dhe mirëmbajtja e rregullt e cilësore.</p> <p>[Ref: Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë, evidenca 2.33].</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Nga takimet e vizita në institucion, GVJ konfirmon se mjediset që i dedikohen procesit mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Ekziston një lidhje e qëndrueshme wifi, që shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimin dhe që ndihmon zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies, si dhe gjithashtu ambientet e mësimdhënies janë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe monitorë, të cilat janë në shërbim të procesit mësimor për Programin e Studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Studentët dhe pedagogët janë të pajisur gjithashtu me një adresë postare elektronike nga institucioni, e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas.</p> <p>Të gjitha zyrat e personelit akademik janë të pajisura gjithashtu me printerë, fotokopje dhe skanerë për të siguruar lehtësi në punën e personelit akademik në funksion të procesit mësimor.</p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	<p>[Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16; Mjediset e Fakultetit të shkencave Sociale /Njësive Bazë, evidenca 2.33; Të dhëna për bibliotekën, evidenca 2.30; Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17), evidenca 2.30.1; Struktura organizative e FSHS, evidenca 2.5; Propozime për projekt buxhetin afatmesëm të departamentit të Sociologjisë, evidenca 3.26; Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/Biblioteka online, etj. (Tabela 17), evidenca 2.30.1].</p>

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me stafin pedagogjik dhe studentët e programit, si dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, rezulton se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (fizike dhe digjitale) për disiplinat në përmbajtje të programit të studimit, është e aksesueshme për studentët në shqip, anglisht dhe gjuhë të tjera, për të garantuar marrjen e dijeve dhe informacionit të nevojshëm. Si procedurë, tekstet mësimore me propozim të titullarëve të lëndëve, miratohen nga departamenti e u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik.</p> <p>Studentët kanë mundësi gjithashtu të aksesojnë në kompjuterët e bibliotekës tituj të ndryshëm librash në PDF. Biblioteka posedon po ashtu revista shkencore të shkencave sociale.</p> <p><i>[Ref: Të dhëna për bibliotekën, evidenca 2.30; Propozime për projektbuxhet vjetor të Departamentit të Sociologjisë, evidenca 3.27; Buxheti për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti, evidenca 2.31; Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, evidenca 2.32].</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në bibliotekën e institucionit, biseda me personelin, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se ajo disponon një numër botimesh, klasike dhe të reja, edhe të viteve të fundit, për fushat kryesore të programit dhe është në pasurim e sipër me tituj të rinj.</p> <p>Referuar raportit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, për vitin akademik 2017-2018 biblioteka ka rreth 3,750 tituj dhe 70 poste leximi, të cilët në 5 vitet e fundit janë pasuruar me një listë prej 869 tekstesh.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në bibliotekën e fakultetit, disponohet literatura bazë dhe ndihmëse, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD-ROM, etj. Nëpërmjet aksesit në bibliotekën digjitale JSTOR ofrohen më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline. Aksesit në U-library https://ulibrary.rash.al/ në bashkëpunim me Rrjetin akademik Shqiptar dhe Universitetit të Tiranës ofron nga databaset kryesore të paketave, ku gjenden mijëra revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin në fusha të ndryshme, përfshirë dhe shkencat sociale dhe Sociologji me rreth 6,600 periodikë dhe revista, mbi 6,000 periodikë peer-reviewed, mbi 4,000 periodikë të Web of Science or Scopus. [Lista e të dhënave të U-library nga Rash: https://ulibrary.rash.al/lista.pdf]. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale garanton gjithashtu një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[Ref: Raporti i fundit i MASR për infrastrukturën në UT, 2017-2018, evidenca 2.34.1; Të dhëna për bibliotekën, evidenca 2.30. https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline. U-library https://ulibrary.rash.al/ Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj., (Tabela 17), evidenca 2.30.1; Të dhëna për bibliotekën, evidenca 2.30; Të dhëna të plota për</i></p>

	<i>platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj., (Tabela 17), evidenca 2.30.1].</i>			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se IAL ka në dispozicion të programit “Bachelor” në “Sociologji” bibliotekën dhe kompjuterë, të cilët shfrytëzohen nga studentët e programit për lëndët e programit për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës, apo studimeve specifike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës e biseda me personelin akademik e studentët, konstatohet se në funksion të mësimdhënies, shfrytëzohet efektivisht platforma online (e-learning). Stafi dhe studentët kanë gjithashtu adresa elektronike, të cilat mundësojnë komunikimin midis tyre për çdo nevojë. <i>[Ref: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), evidenca 3.21; Orare konsultimi me studentë, evidenca 3.25; Udhëzues për provimet online, Njoftim për logimin në platformë https://fshs-ut.edu.al/?p=6463</i> <i>Trajnime në FSHS për përdorimin e platformës Teams dhe paketës Office 365 https://fshs-ut.edu.al/?p=5975</i> <i>Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë, evidenca 1.15; Vendim për disa shtesa në Udhëzuesin e UT-së “Për zhvillimin e mësimin në distancë”, evidenca 1.17].</i> <i>Njoftim për logimin në platformë: https://fshs-ut.edu.al/?p=6035</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.				
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.				
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga biseda e GVJ me stafin akademik dhe studentë të programit, si dhe nga njohja në sekretarinë mësimçore me tematikën e diplomave të studentëve, që kanë përfunduar programin, rezultojnë se procesi i përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomave zbaton rregulloret e institucionit që, për këtë qëllim, ka një dokumentacion të gjerë e të qartë. Udhëheqja e temave bëhet në përputhje me orientimin nga ana e personelit akademik dhe sipas interesit të studentëve, në përshtatje me profilin përkatës. Bazuar në RVB dhe intervistat e zhvilluara, Departamenti i Sociologjisë nxit studentët me rezultate të larta dhe aftësi në kërkim, që në përfundim të detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit të ciklit të parë, që të zgjedhin realizimin e një teme diplome. Mbështetur në Rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” dhe Rregulloren për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, personeli akademik dhe koordinatori i programit të studimit i orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, duke organizuar takime periodike me studentët, që plotësojnë kriterin për përzgjedhjen e temës së diplomës. Për çdo student, që zgjedh të bëjë temë diplome, departamenti cakton një pedagog udhëheqës, detyrat dhe të drejtat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Sociologji”. <i>[Ref: Rregullore e programit të studimit, evidenca 3.6; Rregullore për diplomat e ciklit të parë të studimeve, evidenca 3.6.1].</i>			
	<table border="1"> <tr> <td>Përbushet plotësisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
Standardi III.4 Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti i Tiranës për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies ka ngritur disa struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila garanton cilësinë e aktiviteteve akademike, aktiviteteve kulturore dhe sociale të stafit akademik dhe studentëve, si dhe aktivitetet administrative; - Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimi i cilësisë; - Drejtoria e teknologjisë inovacionit dhe statistikave; - Drejtoria e kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë. <p>Referuar statutit të UT, organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik, i cili ngrë komisionet e përhershme në nivel institucional. Krahas saj, organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme shkencore.</p> <p>Strukturat e ngritura nga ana e institucionit merren me koordinimin e veprimtarisë midis njësive kryesore dhe njësive bazë të programit të studimit sipas rregulloreve të tyre të brendshme.</p> <p>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu II, neni 29, neni 37, nenet 41-42, evidenca 1.2; Struktura organizative e Rektoratit të Universitetit të Tiranës: https://unitir.edu.al/struktura-organizative/; Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, kreu III, neni 29, neni 37, nenet 41-42, evidenca 1.2; Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë 2017, evidenca 2.12; Rregullore e NJSC të FSHS 2020, evidenca 2.14].</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Referuar materialeve të depozituara si rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe ajo e Departamentit të Sociologjisë, si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale, si njësi kryesore mban përgjegjësi për rritjen dhe vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në të gjitha programet që ai ofron. Ndërkohë departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe ndjek proceset mësimore e kërkimore në bashkëveprim me stafin. Departamenti i Sociologjisë organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte, detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë.</p>			
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Baza për zhvillimin e procesit mësimor në UT janë rregulloret, Strategjitë e</p>			



	<p>Mësimdhënies; Plani Strategjik i zhvillimit të departamentit, seminarët dhe trajnimet.</p> <p>[Ref: Strategjia e zhvillimit të Departamentit, kreu III, evidenca 3.2; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 2020-2024, evidenca 3.5; Politika të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies DS, pika 2; Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), evidenca 1.4;</p> <p>https://unitir.edu.al/seminar-online-date-08-11-2021-ora-1500-organizuar-nga-eu-for-innovation-preneurz-amsterdam-team/</p> <p>https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranes-nen-kujdesin-e-rektorit-prof-dr-artan-hoxha-fton-stafin-akademik-te-ut-se-te-marre-pjese-ne-seminarin-online-me-teme-making-degree-programs-more-relevant-and-more/</p> <p>Seminare të ofruara në rang Institucioni: https://unitir.edu.al/?s=seminar Trajtime në kuadër të programeve Erasmus+ https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar takimit në institucion me stafin si dhe dokumenteve të konsultuara, rezultoi që UT akordon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca, si dhe botime të artikujve në revista shkencore. Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet, mundësuar prej ERASMUS +, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ konstaton se botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit.</i></p> <p>[Ref: Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, evidenca 1.4; Strategjia e zhvillimit të Departamentit, evidenca 3.2; Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Sociologjisë 2020-2024, evidenca 3.2.1; Vendim i Departamentit të Sociologjisë për miratimin e prioriteteve të kërkimit shkencor 2021-2024, evidenca 3.2.2; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.5; Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit, evidenca 4.11].</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimit në institucion me drejtuesit e Fakultetit, Departamentit si dhe stafin, rezultoi që IAL nxit stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, workshope, si dhe botime të artikujve në revista shkencore nëpërmjet mbulimit të shpenzimeve financiare. IAL ka zhvilluar gjithashtu trajnime dhe seminare të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësimdhënie, si dhe përdorimin apo implementimin e metodave të reja pedagogjike.</p>

	<p>[Ref: Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional, evidenca 1.20; Seminare të ofruara në rang Institucioni: https://unitir.edu.al/?s=seminar Trajnime në kuadër të programeve Erasmus+ https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim</p>		
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion, si me drejtuesit, ashtu dhe me stafin, GVJ konkludon se personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësitë e stafit akademik janë gjithashtu të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Departamentit të Sociologjisë.</p> <p>Gjithashtu personeli akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, ku p.sh. gjatë periudhës së pandemisë janë përdorur platformat e ndryshme online.</p>		
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>[Ref: CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit, evidenca 4.15; Veprimtaria kërkimore në nivel programi “Bachelor” në “Sociologji” (2018-2021), evidenca 4.6; Dokumentim i aktivitetit të Departamentit ndër vite: https://www.facebook.com/departamentiisociologjiseUT Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT, evidenca 1.16; Vendimi i UT për financim të pjesëmarrjeve në Konferenca shkencore Ndërkombëtare, evidenca 1.16.1; Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, evidenca 3.18</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në Rregulloren e UT-së, (neni 45, 46, 48 dhe 49), gjithashtu në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale (neni 32, 33, 34, 36), në Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë (neni 6, pika e), në Rregulloren e Programit të Studimit (kreu IV) si dhe në programet mësimore të lëndëve të programit të studimit. Në këto dokumente përcaktohet si formë kryesore e vlerësimit provimi. Kontrolli i dijeve bëhet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Kontrolli i vazhdueshëm përcaktohet nga lektorët në programet mësimore duke përfshirë forma të ndryshme si pjesëmarrja dhe angazhimi në seminare, detyra kursi, punë</p>

	<p>minikërkimore, teste me alternativa dhe provimi përfundimtar. Në rregulloret e përmendura përcaktohen përgjegjësit për hartimin dhe miratimin e tezave të provimit, kriteret e futjes në provim për studentët, afatet e provimeve, mënyra e zhvillimit të provimit, procedurat e verifikimit dhe të sekretimit të provimeve, sistemi i vlerësimit me pikë, njohja e studentëve me rezultatet e provimeve, e drejta e anketimit etj. Gjatë takimit me GVJ, studentët u shprehën se ata njihen me kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive që në orët e para të leksioneve, kur marrin programin e lëndës dhe i shpjegohen nga lektori i lëndës.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Evidence 3.3; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Programet e lëndëve, Evidenca 4.3].</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit është i përcaktuar qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo lënde apo moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga titullari i lëndës. (përkatësisht në Rregulloren e FSHS, neni 32 pika 1 dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, kreu IV, neni 16.1).</p> <p>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6].</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT-së dhe Rregulloren e FSHS-së, forma kryesore e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore është provimi i cili realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Në rregulloren e programit të studimit, përkatësisht nenin 16 pika 16.2, specifikohet se përveç provimit vlerësimi mund të bëhet me detyra kursi, projekte, postera ose bazuar në një shumëllojshmëri formash të vlerësimit.</p> <p>Gjithashtu në programet mësimore të lëndëve lektorët përdorin forma të ndryshme të vlerësimit bazuar në specifikat e lëndëve që zhvillojnë, si vlerësimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes së studentit, punët minikërkimore, testet me alternativa etj.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Evidence 3.3; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Programet e lëndëve, Evidenca 4.3].</p>

	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Studimeve të UT-së, Rregulloren e FSHS-së, Rregulloren e Programit të Studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit gjatë gjithë semestrit si aktivizim në mësim, si testimi i gjatë vitit/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet bazuar në mbledhjen e pikëve që ai merr në realizimin e këtyre detyrimeve:</p> <p>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10-30 %</p> <p>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 10-30%</p> <p>Testimet gjatë vitit 10-20 %</p> <p>Provimi përfundimtar 60-90%</p> <p>Përqindja e secilit komponent përcaktohet nga lektori i lëndës sipas specifikës së secilës lëndës.</p> <p>Këto forma të vlerësimit të integruara nxisin studentët të mësojnë sistematikisht dhe në vazhdimësi gjatë zhvillimit të lëndës apo modulit.</p> <p>[Ref: Programet e Lëndëve, Evidenca 4.3; Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidence 3.6; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar të dhënave të deklaruara nga grupi i RVB, për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur subjektivitetin përdor sistemin Clean Score, në bashkëpunim me AADF. Ky sistem mundëson korrigjimin automatik të pyetjeve me alternativa dhe në këtë mënyrë rritet shpejtësia e korrigjimit dhe shmangen gabimet që mund të bëhen në korrigjimin manual.</p> <p>Mirëpo nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka të dhëna sa lektorë të Departamentit të Sociologjisë e kanë përdorur atë në 3 vitet e fundit akademike.</p> <p>[Ref: Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation dhe Universitetit të Tiranës për shtrirjen e projektit “Clean Score: cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studentëve, evidenca 1.10.1].</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, nga të cilët njëri është i</p>

<p>komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>brendshëm. Në Rregulloren e Programit të Studimit diferencohen komisioni i vlerësimit (kur ka dy ose më shumë pedagogë të lëndës) dhe komisioni i provimit (titullari i lëndës dhe një pedagogë tjetër). Komisionet ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale. [Ref: Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidenca 3.6; Rregullore për Mësimdhënien, të Nxënit dhe Provimet, Evidenca 2.10].</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar ne Rregulloren e UT-së, neni 48, provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Në Rregulloren e FSHS-së, neni 35 pika 2, është e përcaktuar edhe mënyra e sekretimit nëpërmjet sekretimit të thjeshtë ose me systemin BarCode. Këtë sekretim e bën komisioni pasi identifikon përmes dokumentit të identifikimit studentin. Më pas lista emërore me Barcode mbyllet në zarf, sekretohet dhe firmoset nga komisioni e i dorëzohet drejtuesit të departamentit për t’u ruajtur sipas procedurave të protokoll arkivës. [Ref: Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4].</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, neni 19, garanton komunikimin e vlerësimit të studentit jo vetëm përmes sistemit informatik por edhe përmes takimit me studentët. Gjithashtu përcaktohet qartë e drejta e studentit për tu konsultuar me pedagogun e lëndës mbi arsyet që e kanë çuar në atë vlerësim. Ndarja e vlerësimit në disa elementë si angazhimi në seminare, detyrat e kursit, minitestet bën që komunikimi midis pedagogëve dhe studentëve të jetë i vazhdueshëm. Nga takimi i GVJ me studentët, konstatohet që ata njihen me vlerësimet nga ana e pedagogëve dhe sqarohen për këtë vlerësim. [Ref: Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidencë 2.4].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë, Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Rregulloren e Diplomimit, në Kodin e Etikës në UT dhe programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, janë të shprehura qartë kërkesat dhe kriteret për të respektuar të drejtat e autorit dhe për të realizuar punime origjinale në respekt të etikës së kërkimit., sikurse janë të specifikuara masat që ndërmerren në raste të shkeljes së tyre. Gjithashtu fakti që provimet realizohen nga komisione të përbëra nga të paktën dy pedagogë, rrit mundësinë për të shmangur kopjimin. [Ref: Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.3; Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidenca 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1; Kodi i Etikës në UT, Evidenca 1.5].</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të</p>

<p>kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>kontrollit stafi akademik shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, tezat miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbalin e detyrimeve.</p> <p>Në Rregulloret e UT-së dhe të FSHS-së shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet në sistemin me notë. Për të përcaktuar notën përdoret sistemi i vlerësimit me pikë të cilat kthehen në notë. Në rregullore është e përcaktuar qartë që rezultatet duhet t’iu bëhen të njohura studentëve në përfundim të provimit me gojë dhe brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit me shkrim. Rezultatet komunikohen individualisht. Gjithashtu në Rregulloren e FSHS-së, neni 34 pika 7, përcaktohet detyrimi i pedagogut për të bërë publik çelësin e përgjigjeve nëse pyetjet janë me alternativa.</p> <p>[Ref: Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4].</p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin e Departamentit të Sociologjisë dhe me studentët e programit të studimit, GVJ konstaton se institucioni garanton të drejtën e studentit për t’u ballafaquar me vlerësimin e fituar nga realizimi i detyrimeve që i bëhen të qarta nga pedagogu që në orën e parë të leksionit dhe janë të vendosura edhe në sylabusin e lëndës. Studentit i njihet e drejta për t’u ankuar për rezultatin përfundimtar të provimit.</p> <p>[Ref: Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4; Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidenca 3.6].</p>		
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion GVJ konstaton se studentëve i jepet e drejta që çdo kërkesë apo ankesë ta paraqesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit. Përgjegjësi i Departamentit bën verifikimet dhe vë në dijeni dekanin. Dekani brenda 48 orësh duhet të ngre komisionin ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanin, komisioni përcakton vlerësimin. Procedura e ankimit protokollohet dhe arkivohet dhe rezultati final paraqitet në regjistrin e notave.</p> <p>[Ref: Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidenca 2.4; Rregullore e Programit të Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji”, Evidenca 3.6; Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në fushën e programit të studimit.</p> <p>Referuar dokumentacionit të paraqitur, plani mësimor për programin e studimit “Bachelor” në “Sociologji” përmban:</p> <p>Lëndë bazë – 7 (35 kredite me peshë specifike 19.5%)</p> <p>Lëndë karakterizuese – 21 (96 kredite me peshë specifike 53.3%)</p> <p>Lëndë ndërdisiplinore/Integruese - 6 (25 kredite me peshë specifike 13.9%)</p> <p>Lëndë plotësuese – 4 (18 kredite me peshë specifike 10%)</p> <p>Detyrime përmyllëse (temë diplome ose provim formimi) 6 kredite me peshë specifike 3.3%.</p> <p>Kurrikula e programit i mundëson studentëve një formim të plotë për fushën e studimit dhe i'u jep mundësinë të ndjekin studimet e ardhshme në shumë specializime të fushës, qoftë në mësimdhënie por edhe specializime që i mundësojnë punësimin në institucione private dhe publike.</p> <p><i>[Ref: Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E), Evidencë 4.2].</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje dhe në zbatimin të VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmyllëse</p> <p>Programi i studimit përmban lëndë bazë, ndërdisiplinore dhe plotësuese të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën humane e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit, në gjuhë të huaja me lëndë si Hyrje në Psikologji, Shkrim akademik, Filozofi, Histori, Antropologji Sociale, Ekonomi, Logjikë, Anglisht/Frëngjisht, etj.</p> <p><i>[Ref: Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E), Evidencë 4.2; Programet e lëndëve, Evidencë 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Programi i studimit, bazuar në kornizën konceptuale, ka si synim të pajisë studentët me disa kompetenca dhe aftësi të cilat përputhen në pjesën më të madhe me kompetencat dhe aftësitë që synojnë lëndë të ndryshme përmes silabuseve.</p> <p>Referuar raportit RVB këto kompetenca dhe aftësi janë objekt i analizës dhe diskutimeve Por nuk është e qartë se si realizohet ky proces.</p> <p><i>[Ref: Programet e lëndëve, Evidencë 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dhe takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e programit “Bachelor” në “Sociologji”, në përfundim të çdo lënde apo moduli personeli akademik diskuton me studentët çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p> <p><i>[Ref: Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Sociologji”, 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur (Evidenca 4.6 dhe evidence 3.24) grupi i RVJ konstaton se Departamenti i Sociologjisë organizon</p>

<p>teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>aktivitete shkencore (rreth 18 për kohën në shqyrtim) me një numër pjesëmarrësish të konsiderueshëm. Personeli akademik ka realizuar rreth 15 leksione të hapura dhe seminare me lektorë të huaj, si dhe shumë leksione të hapura dhe forume diskutimi nga lektorë shqiptar ose specialist të ndryshëm, në fusha interesi të ndryshme si sociologjia e migrimit, sociologjia e kulturës, studime historike, ekstremizmi i dhunshëm, efektet sociale të ndryshimeve klimaterike, sociologjia gjinore, drejtësia tranzitore etj. <i>[Ref: Veprimtaria Kërkimore në Nivel Programi "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 4.6; Aktivitete të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.26].</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.</p>	<p>Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orientuara drejt lidhjes së ngushtë të dijeve sociologjike me kontekstin bashkëkohor, teoritë dhe paradigmat orientojnë zhvillimin e kompetencave për hulumtimin e dinamikave sociale. Studentët orientohen drejt praktikave kërkimore në mënyrë që të rrisin aftësitë përshtatëse në tregun e punës si kërkues social ose sociologë. Gjithashtu Departamenti i Sociologjisë i ofron studentëve shumë mundësi për zhvillimin e praktikave mësimore, ku mund të zhvillojnë njohuritë e fituara. (Referuar evidences 3.21, janë rreth 51 institucione publike dhe private me të cilat Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi) <i>[Ref: Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunue, Evidencë 3.21; Dosje e Leksioneve. Aktiviteteve, Konferencave, Evidencë 4.19].</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Referuar RVB dhe programeve të lëndëve të programit të studimit, personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në pjesën më të madhe të silabuseve është e përcaktuar që një pjesë e pikëve të vlerësimit fitohen nga studentët me anë të pjesëmarrjes dhe diskutimit në leksione dhe seminare për tema të ndryshme, realizimit të detyrave në grup, realizimit të minikërkimeve shkencore në grup etj. Këto motivojnë dhe nxisin studentët për të shprehur pikëpamjet e tyre. <i>[Ref: Programet e lëndëve, Evidencë 4.3].</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Sociologjisë krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative duke e bazuar vlerësimin e studentit jo vetëm përmes provimit por edhe përmes formave të tjera të kontrollit të dijeve si pjesëmarrje në diskutime mbi çështje aktuale, përgatitje e detyrave të kursit në grup ose individuale, përgatitje e punëve minikërkimore si pjesë për vlerësim në shumë silabuse të programit etj. Këto forma të stimulimit të studentëve për të vënë në zbatim njohuritë e fituara në lëndë/modulet e zhvilluara, e bëjnë leksionin më të tërheqës dhe nxisin studentin të zhvillojë mendimin kritik dhe ide novative për zgjidhje të problemeve të ndryshme sociale. Bazuar në evidencën 4.6, rreth 37 studentë të programit të studimit të Sociologjisë janë angazhuar e mbështetur nga pedagogët e tyre për të marrë pjesë në një sërë aktiviteteve si konferenca shkencore, në projekte të ndryshme, në konkurse etj.</p>

	[Ref: Programet e lëndëve, Evidencë 4.3; Veprimtaria Kërkimore në Nivel Programi në "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 4.6].			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	<p>Bazuar në evidencën 2.26, institucioni ofron mbështetje akademike për studentët duke i ndihmuar ata për zhvillimin e karrierës dhe mbështetje për procedurat e mobilitetit të studentëve.</p> <p>Referuar RVB, Universiteti i Tiranës i akordon një fond vjetor Këshillit Studentor si mbështetje për aktivitetet dhe implementimin e ideve novatore, por nuk ka asnjë të dhënë mbi këtë fond dhe numrin e studentëve që kanë përfituar nga ai.</p> <p>Të dhënat evidencës 4.6 tregojnë për mbështetje nga personeli akademik në angazhimin e studenteve me aktivitete ku nxitet kërkimi shkencor, zhvillimi i ideve inovative por nuk ka të dhëna për mbështetjen financiare.</p> <p>[Ref: Politika për Mbështetjen për Studentët dhe Strukturat e Tyre Organizative, Evidencë 2.26; Veprimtaria Kërkimore në Nivel Programi në "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 4.6].</p>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e disponuar institucioni ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi sic tregohet nga evidencat 3.19 dhe 3.21. Referuar evidencave 4.6 dhe 3.24 mund të dallojmë që Departamenti i Sociologjisë organizon shumë leksione të hapura, seminare dhe aktivitete të ndryshme me pedagogë, specialist dhe ekspertë të institucioneve bashkëpunuese.</p> <p>Departamenti ka edhe raste të mobilitetit të dy studentëve përmes projekteve europiane të shkëmbimit Erasmus.</p> <p>Sugjerohet që të punohet më shumë në këtë aspekt, për të rritur numrin e studentëve të programit "Bachelor" në "Sociologji" të cilët marrin pjesë në mobilitete.</p> <p>[Ref: Raport Periodik Analitik i Përfitimeve nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit, Evidencë 3.19; Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese..., Evidencë 3.21; Aktivitete të departamentit, Evidencë 3.24; Veprimtaria Kërkimore në Nivel Programi në "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 4.6].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Grupi i RVJ mbështetur në dokumentacionin e paraqitur konstaton se insitucioni ka procedura të posaçme për provimin final ose temën e diplomës dhe kjo është e njohur për studentët. Në Rregulloren e Programit të Studimit, neni 15, përcakton se studenti për të fituar diplomën duhet të japë provimin final ose të mbrojë një punim diplome. Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës janë të përcaktuara në

	<p>Rregulloren për Diplomat e Ciklit të Parë “Bachelor” në “Sociologji” (evidencë 3.6.1) ku specifikohet se kush ka të drejtë të realizojë një punim diplome, si zgjidhet, përcaktohet e miratohet tema e diplomës, zgjedhja e udhëheqësit, të drejta dhe detyrimet, si ngrihet komisioni i vlerësimit, struktura e punimit dhe kriteret mbi etikën e studimit.</p> <p>Për Studentët që nuk plotësojnë kriterin e notes mesatare, vihet në dispozicion nga departamenti një program studimi për provimin e formimit.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1; Programi I Provimit të Formimit, Evidencë 3.6.2].</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë dhe personeli akademik asistojnë studentët duke i vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme përmes Programit të Provimit të Formimit (Evidenca 3.6.2) dhe Rregullores për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve ‘Bachelor’ në “Sociologji”.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1; Programi I Provimit të Formimit, Evidencë 3.6.2].</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar RVB në semestrin e dytë të vitit të tretë, departamenti harton dhe miraton programin e provimit të formimit të cilin e përcjell për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore. Programi i referohet lëndëve të zhvilluara përgjatë 3 viteve të studimeve. Komisioni i hartimit të tezës kujdeset që të jetë gjithëpërfshirës në tezën që harton me pyetje nga program i studimit të shpërndarë tek studentët.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Programi i Provimit të Formimit, Evidencë 3.6.2].</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Departamenti ka në dispozicion të studentëve një rregullore për diplomat e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, në këtë rregullore janë të përcaktuara kriteret, të drejta dhe përgjegjësi të udhëheqësit, struktura e temës dhe të tjera elementë të nevojshëm për të ndihmuar studentët në përpilimin e temës së diplomës. Në këtë rregullore është e përcaktuar se udhëheqësi duhet të bëjë transparent kalendarin e takimeve për konsultime, të japë mbështetje akademike për formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës, përgatitjen e punimit etj.</p> <p>Për sa i përket mbështetjes së studentëve për përgatitjen provimit final RVB referon se në bazë të kërkesave dhe nevojave të studentëve vihet në dispozicion një orar konsultimesh.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1; Programi I Provimit të Formimit, Evidencë 3.6.2].</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e</p>	<p>Referuar RVB pedagogët ndihmojnë studentët me kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma kërkimore.</p>


<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët mund të përdorin ambientet e fakultetit për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizës statistikore etj. Departamenti dhe personeli akademik asiston studentët në lehtësimin e kryerjes së matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucione apo jashtë tij sepse kjo është e përcaktuar në rregulloren e përgatitjes së diplomës. [Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1].</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren për Diplomat e Ciklit të Parë, neni 6, udhëheqësi ka përgjegjësi të takojë studentin për konsultime, të japë mbështetje akademike në formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë, rekomandimin e literaturës, konsulencën për përgatitjen e punimit. Ai ka detyrimin të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës, të mbajë takime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit, të vlerësojë progresin dhe monitorojë standardin e punës së tij; të japë ose jo leje për mbrojtje. [Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1].</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të formimit ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me pikë të cilat konvertohen në notë sipas një sistemi të detajuar. (Evidenca 3.6, neni 16). Për vlerësimin e punimit të diplomës bazuar në evidencën 3.6.1, ngrihet nga përgjegjësi i departamentit një komision i cili përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, dhe miratohet nga dekani. Komisioni në fund të prezantimeve bën vlerësimin e tyre me notë. Gjithashtu në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret e vlerësimit (Neni 9). [Ref: Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1].</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur, me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme studentët, që kanë plotësuar kërkesat e planit mësimor dhe kanë dhënë provimin e formimit/temën e diplomës, pajisen me Diplomë Universitare “Bachelor” në “Sociologji” të shoqëruar me listën e notave si dhe me suplementin e diplomës. [Ref: Statuti I UT-së, neni 111, Evidencë 1.2; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” neni 22, Evidencë 3.6; Modeli i Diplomës, Evidencë 3.8; Modeli i Suplementit të Diplomës për Programin e Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.10].</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT-së (Neni 111) dhe Rregulloren e Programit të Studimit (Kreu V), studentit pasi pajiset me Diplomë Universitare të miratuar nga Ministria e Arsimit ka në dispozicion një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, e cila është e detajuar edhe në suplementin e diplomës. [Ref: Statuti I UT-së, neni 111, Evidencë 1.2; Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” neni 22, Evidencë 3.6].</p>

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni bazuar në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore (neni 4 pika g dhe s), përcakton që sekretaria mësimore administron, mirëmban e ruan rregjistrin themeltar, rregjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave; procesverbalet e provimeve; dosjet me dokumentacionin e regjistrimit dhe të ç'regjistrimit të studentëve dhe dokumentacionin statistikor përkatës; arkivon dosjet e studentëve të diplomuar.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me sekretarinë u konstatua se institucioni ruan në mënyrë të rregullt regjistrat zyrtar të studentëve. Sekretarisë ju kërkua vënia në dispozicion e regjistrit të studentëve, e cila ishte plotësuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore, në lidhje me programin e studimit Bachelor në "Sociologji", disponon të dhënat për çdo semestër, për çdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna dokumentohen veprimtaria e pedagogut në 4 aspekte: mësimdhënie, kërkim shkencor, kontribut institucionale dhe kontribut profesional.</p> <p>GVJ nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezulton se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore (1 PAK dhe 1 PAE), gjendet dokumentacioni si, kontratë e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, formular i vetdeklarimit ose vërtetim i gjendjes gjyqësore, raport mjeko-ligjor, CV, certifikata kualifikimesh apo pjesëmarrjesh në konferenca etj.</p>



	<i>[Ref: Informacion për Politikën e Burimeve Njerëzore dhe Vlerësimin e Pedagogut, Evidencë 2.22; Marrëveshje për Organizimin e Kohës Vjetore të Punës për Personelin Akademik, Evidencë 2.20].</i>
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së si edhe nga vizita në institucion, rezulton se UT, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentesh të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik. Këto procedura janë të specifikuar në Statutin e UT-së (neni 67 dhe 68) dhe Manualin për Punësimin e Personelit në UT. Në këto dokumente janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi bazën e të cilëve përzgjidhet stafi si dhe procedurat e rekrutimit që nga shpallja e vendit të punës, ngritja e komisionit për përzgjedhjen, afatet kohore, vlerësimi i dosjes dhe intervistat, shpallja e fituesit, kontrata e punës e tj.</p> <p>Procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë/të pjesshme, të personelit ndihmës akademik, të stafit ndihmës akademik me karakter administrativ, të personelit administrativ janë më të detajuara në Manualin për Punësimin e Personelit në UT. Ky manual njehson dhe standardizon procedurat e përzgjedhjes dhe punësimit në të gjithë institucionin, si dhe siguron një proces më të drejtë, më të hapur, duke përzgjedhur në bazë të meritave dhe aftësive të kandidatëve.</p> <p><i>[Ref: Statuti I UT-së, Evidencë 1.2; Manual për Punësimin e Personelit në UT, Evidencë 1.12].</i></p>
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se institucioni harton procedura dhe kritere të posaçme për rekrutimin e personelit. Këto procedura gjenden në nenin 67 dhe 68 të Statutit të UT-së, por janë të detajuara në Manualin e Punësimit të Personelit në UT. Në këto dokumente janë të përcaktuara qartë hapat që duhen ndjekur, procesi, referencat ligjore si dhe afatet kohore për secilin hap. Në bazë të dokumentacionit njësisia bazë, bazuar në nevojat aktuale, përcakton kriteret e veçanta dhe të përgjithshme. Vendimi i departamentit i përcillet rektorit. Pasi shqyrtohen, rektori miraton ose i kthen për rishqyrtim nëse konstaton kritere në kundërshtim me ligjin. Pasi rektori të autorizojë vazhdimin e procedurave, drejtuesi i njësisë kryesore bën shpalljen e konkursit publik në APP si dhe në faqen zyrtare të njësisë. Më pas krijohet komisioni ad-hoc nga drejtuesi i njësisë bazë me përfaqësues nga njësisia dhe rektorati. Komisioni vlerëson dokumentacionin, njofton kandidatët nëse kalojnë apo jo në fazën e dytë dhe përcakton pikëzimin për çdo fazë të konkursit. Zgjidhet kandidati fitues dhe shpallet duke u publikuar në faqen e njësisë kryesore. Kandidatëve jo fitues i njihet e drejta e ankimimit. Emri i kandidatit fitues i paraqitet rektorit të UT-së i cili nënshkruan kontratën e punës dhe krijohet dosja personale e personelit akademik.</p> <p><i>[Ref: Statuti I UT-së, Evidencë 1.2; Manual për Punësimin e Personelit në UT, Evidencë 1.12].</i></p>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të	GVJ konstaton se institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në kritere të hartuara në përputhje me natyrën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në Manualin e Punësimit për të garantuar përzgjedhjen e personelit vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision i përbërë prej 5 anëtarësh, 2 prej të cilëve përzgjidhen nga drejtuesi i njësisë bazë, dy përzgjidhen nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe 1 nga rektori i UT-së. Komisioni ad-hoc në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe përgatit një relacion. Vlerësimi përfshin dy faza, vlerësimin e dosjes dhe intervistën. Komisioni përcakton pikëzimin për cdo fazë të konkursit dhe për cdo kriter të shpallur. Konkurimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore. [Ref: Statuti I UT-së, Evidencë 1.2; Manual për Punësimin e Personelit në UT, Evidencë 1.12].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar RVB dhe dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale ofron mjedise të përshtatshme për t'i ardhur në ndihmë personelit që të kryejë në mënyrë profesionale detyrat. FSHS ka 6 salla për leksionë, 18 klasa për seminare, 1 sallë për aktivitete promovuese, 1 sallë internet, 1 sallë për bibliotekën, mjedis për fotokopjime. Departamenti ka zyrën e tij dhe personeli akademik ka zyra të pajisura me kompjuter, internet, fotokopje etj. Biblioteka ka rreth 2750 tituj dhe 70 poste leximi. Institucioni i siguron stafit pa pagesë, akses në bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE, etj. [Ref: Të Dhëna për Infrastrukturën, Evidencë 2.32].
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni nxit kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit të programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Fakulteti mbështet pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe gjithashtu mundëson publikimin e artikujve dhe studimeve shkencore në revista shkencore si “Politikja”, “Lente Sociologjike” si dhe revista të tjera të financuara nga buxheti për kërkimin në FSHS. Bazuar në Evidencën 4.11, personeli akademik i studimit ka në veprimtari të pasur kërkimore gjatë viteve të fundit, me botime të teksteve monografikë, tekste universitarë, tekste për arsimin parauniversitar, artikuj të botuar në revista brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Numri i botimeve nga PAE i programit të studimit është 49. Departamenti ka zbatuar dy projekte dhe ka organizuar 18 aktivitete shkencore. (Tabela 19)

	<p>Mirëpo nuk ka të dhëna të specifikuar mbi mbështetjen institucionale për kualifikimin e vazhdueshëm dhe punën kërkimore të stafit. Gjatë takimit me GVJ, stafi akademik u shpreh se do të mund të organizonin më shumë aktivitete kërkimore dhe projekte nëse do të kishin më shumë mbështetje financiare nga institucioni.</p> <p>[Ref: Raport Periodik Analitik Bazuar në të Dhënat për Kualifikim dhe Kërkimin Shkencor të Personelit Akademik në 5 Vitet e Fundit, Evidencë 4.11].</p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Referuar RVB, Universiteti i Tiranës organizon trajnime dhe seminare për kualifikimin e stafit për të përdorur metodat inovative mësimore si dhe për përmirësimin e kurrikulave sipas objektivave të Unionit Europian, përmes ‘Qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional.’ Vitet e fundit rëndësi i është kushtuar trajnimeve për përdorimin e metodave të mësimi online, si rezultat i kontekstit pandemik.</p> <p>Por mungojnë të dhënat mbi numrin e stafit të programit të studimit që ka marrë pjesë në seminare ose trajnime të organizuara nga kjo qendër.</p> <p>[Ref: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/ https://fshs-ut.edu.al/?p=5975 https://fshs-ut.edu.al/?p=7780/].</p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’.</p> <p>Referuar dokumenteve që shoqërojnë RVB-në (Evidenca 4.12), stafi akademik i angazhuar në program për vitin akademik 2020-2021 përbëhet nga 9 pedagogë efektivë (PAE) dhe 21 pedagogë (PAK) me kontratë, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr., - 1 Prof. Asoc. Dr., - 15 Dr., - 4 Dr në proces, - 8 Msc, <p>Personeli akademik në dispozicion të programit është i specializuar sipas fushave përkatëse.</p> <p>Në dispozicion të programit të studimit janë dhe kapacitete njerëzore mbështetëse me funksione administrative dhe ndihmës-akademike.</p> <p>[Ref: Tabelë Përmbledhëse, Evidencë 4.12, (Tabela 1 dhe Tabela 2)].</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1612 750 1680">Përmbushje pjesërisht</th> <th data-bbox="750 1612 965 1680">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1612 1173 1680">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1680 750 1731"></td> <td data-bbox="750 1680 965 1731"></td> <td data-bbox="965 1680 1173 1731" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushje pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushje pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Intitucioni siguron mjedise të mjaftueshueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore në përputhje me natyrën e programit të studimit. Sipas Evidencës 2.32 sipërfaqja e fakultetit është 4400 m², dhe mësimi zhvillohet me dy turne (Cikli i I turni i parë dhe cikli i II turni i dytë.). Përkatësisht mjediset e FSHS-së kanë 6 salla për leksione (898 m²), 16 klasa për seminare (956 m²), 2 salla për aktivitete promovuese, 1 sallë interneti. Numri i studentëve në FSHS është 2690 studentë ndaj fakulteti ofron një normë rreth 2.6 m². [Ref: Të Dhëna për Infrastrukturën, Evidencë 2.32].</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar RVB dhe Evidencës 2.32 dhe vëzhgimit gjatë vizitës Fakulteti i Shkencave Sociale ka në dispozicion klasa, zyra, auditorë, kënd për studentët të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me videoprojektor, personeli akademik pajiset me laptop. Hapësirat e Zhvillimit të veprimtarisë mësimore janë të përshtatshme në ndriçim e hapësirë për të facilituar zhvillimin e mësimi.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Referuar RVB, institucioni ofron mjete dhe mjedise të përshtatshme për plotësimin e kërkesa të moduleve, aftësimin teorik e praktik, bazuar në natyrën specifike të programit të studimit. [Ref: Të Dhëna për Infrastrukturën, Evidencë 2.32].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në evidencën 2.32 Fakulteti i Shkencave Sociale NUK ka laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programeve të studimit që ofron. Por sipas RVB, duke pasur parasysh profilin e programit të studimit, institucioni ofron në mjediset e bibliotekës përveç posteve të studimit të literaturës edhe pajisje të teknologjisë së informacionit të pajisura me aksesin në programe profesionale si SPSS, dhe akses në biblioteka/library digjitale, akses në revista shkencore të profilizuara sipas programeve të studimit që ofrohen. [Ref: Të Dhëna për Infrastrukturën, Evidencë 2.32].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë garanton në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji”. Konkretisht bazuar në evidencën 3.21, tabela 5, Departamenti ka 85 marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale. [Ref: Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese në rang Programi Studimi për Praktikave Profesionale, Tabela 5, Evidencë 3.21].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në Evidencën 2.29, FSHS ka një bibliotekë mësimore me një sipërfaqe 200 m ² , e cila ka 4 mjedise: sallën multimediale të pajisur me kompjuterë, sallën e leximit me libra me fond të hapur, sallën e fondit të mbyllur dhe zyrën e përpunimit të koleksioneve. Biblioteka ka 74 poste pune dhe dy punonjëse. Biblioteka ofron shërbimin nga e hëna në të premte nga ora 8.00-18.00. <i>[Ref: Informacion për Bibliotekën, Evidencë 2.29].</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bazuar në RVB, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën e sociologjisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse, edhe pse në fushën e sociologjisë është e nevojshme që biblioteka të pasurohet më tej me më shumë literature në dispozicion të studentit në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. <i>[Ref: Të Dhëna për Bibliotekën, Evidencë 2.29; Buxhetimi për Pasurimin e Bibliotekës në vitin e Fundit në Nivel Fakulteti, Evidencë 2.30; Të Dhëna për Burimet e Literaturës për Programin e Studimit që Ofrohen nga Biblioteka e FSHS-së, Burimet Online, Evidencë 4.10].</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion studentët kanë akses në bibliotekat online dhe janë pa pagesë dhe sigurojnë akses të barabartë për të gjithë studentët. Aksesit në resurset on-line të bibliotekës mund të sigurohet edhe jashtë mjediseve të FSHS-së duke përdorur kredencialet përkatëse. Studentët kanë akses në këto biblioteka online: JSTOR, U-library, UNRISD etj. <i>[Ref: Të Dhëna për Bibliotekën, Evidencë 2.29; Buxhetimi për Pasurimin e Bibliotekës në vitin e Fundit në Nivel Fakulteti, Evidencë 2.30; Të Dhëna për Burimet e Literaturës për Programin e Studimit që Ofrohen nga Biblioteka e FSHS-së, Burimet Online, Evidencë 4.10].</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Referuar RVB dhe dokumentacionit, biblioteka e FSHS-së disponon një sallë multimediale që është e pajisur me kompjuterë për studentët. Por sipas evidencës 4.10 në këtë sallë ka vetëm 8 kompjuter, të cilët janë shumë pak në raport me numrin e studentëve të fakultetit. Sipas RVB këta kompjuter janë të pajisur me programe kompjuterike të nevojshme për studentët, gjithashtu studentët kanë akses të palimituar në internet dhe wi-fi.

	[Ref: Të Dhëna për Bibliotekën, Evidencë 2.29; Buxhetimi për Pasurimin e Bibliotekës në vitin e Fundit në Nivel Fakulteti, Evidencë 2.30; Të Dhëna për Burimet e Literaturës për Programin e Studimit që Ofrohen nga Biblioteka e FSHS-së, Burimet Online, Evidencë 4.10].		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, pasurimi i fondit të bibliotekës së FSHS-së me literaturë të re kryesisht në fushën e sociologjisë realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore dhe zyrës së financës. Bazuar në evidencën 1.2, neni 122, cdo vit Bordi i Administrimit duhet të miratojë një fond të vecantë për blerjen e literaturës shkencore. Referuar evidences 4.10 (në excel) biblioteka e FSHS-së është pasuruar gjatë 5 viteve të fundit me 869 tituj të rinj në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze, francize, italiane etj). Departamenti vë në dispozicion dokumente të cilat vërtetojnë pasurimin e bibliotekës me tituj specifik për programin e studimit "Bachelor" në "Sociologji". [Ref: Statuti I UT-së, Evidencë 1.2; Buxhetimi për Pasurimin e Bibliotekës në vitin e Fundit në Nivel Fakulteti, Evidencë 2.30; Propozim për Blerje Librash nga Departamenti I Sociologjisë, Evidencë 3.9; Propozime për Projekt Buxhetin afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.26, 3.27].		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve nga dita e Hënë deri në të Premte, nga ora 8.30 deri në 18.00. Aksesit në resurset online të bibliotekës mund të sigurohet edhe jashtë mjediseve të FSHS-së duke përdorur kredencialet përkatëse. Grupi i GVJ konstaton se orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojat e studentëve. [Ref: Të Dhëna për Bibliotekën, Evidencë 2.29].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Grupi i RVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale disponon, bazuar në Evidencën 2.9, një procedurë sistematike për menaxhimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Në rregulloren e sekretarisë mësimore, neni 4, përcaktohen detyrat e sekretarisë: për të administruar të dhënat akademike dhe personale të studentëve; për të ndjekur procesin e regjistrimit dhe ç'regjistrimit e transferimit të studentëve; për të administruar, mirëmbajtur dhe ruajtur regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave,

	<p>procesverbalet e provimeve, dokumentacionin statistikor; për të menaxhuar sistemin elektronik; për të përpunuar të dhëna statistikore etj.</p> <p>[Ref: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së, Zyra e Burimeve Njerëzore administro dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik. Informacioni kryesor administrohet në formën hard copy, ndërsa pasurimi i tij kohë pas kohe bëhet në version elektronik.</p> <p>[Ref: Informacion për Politikën e Burimeve Njerëzore dhe Vlerësimin e Personelit, Evidencë 2.20].</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe Programit të Transparencës në UT, Rregullores për Funkcionimin e Sistemit Informatik në UT, personeli dhe studentët e programit të studimit kanë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente që nuk janë objekt i rregullimit me rregulloren e të dhënave personale. Gjithashtu RVB referon se insitucioni po punon për krijimin e një sistemi të dedikuar informatik, ku pedagogët e studentët të kenë mundësi të aksesojnë dokumente e informacione.</p> <p>[Ref: Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në UT, Evidencë 1.8; Privatësia, Evidencë 1.9; Rregullore për Funkcionimin e Sistemit Informatik në UT, Evidencë 1.10].</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB, sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit midis personelit akademik dhe studentëve. Përveç komunikimit zyrtar me anë të emaileve, përdoret edhe platforma Microsoft Teams që ndodhet në faqen e Insitucionit (pjesa e aksesit online në: https://unitir.edu.al/aksesi-online/). Referuar RVB-së në këtë platformë mund të diskutojnë në mënyrë interaktive, të shohin rezultatet e komentet për vlerësimin për detyrat dhe notat.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Referuar RVB Sistemi i menaxhimit të brendshëm të FSHS-së mundëson raportimit e aktivitetete në kohë reale përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit nëpërmjet personelit ndihmës akademik dhe personelit të monitorimit të m/simit. Raportimi bëhet kryesisht përmes grupeve të komunikimit zyrtar dhe nëpërmjet adresave zyrtare duke siguruar të dhëna në kohë reale për organet drejtuese.</p> <p>[Ref: Model Raportimi i Zëvendësimit të Mësimin, Evidencë 3.29; Formular Raportimi i mësimin, Evidencë 3.29.1].</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Referuar RVB dhe faqeve të internetit të UT-së (https://unitir.edu.al/eng/; https://unitir.edu.al/) si dhe faqes së internetit të FSHS-së (https://fshs-ut.edu.al/) informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.</p>
	<p>Përbushet pjesërisht</p>
	<p>Përbushet kryesisht</p>
	<p>Përbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit

X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

GVJ konstaton se institucioni harton raport financiar të kostove të programit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit 'Bachelor' në 'Sociologji'. Departamenti harton raportet financiare të cilat më pas përfshihen në plan buxhetin e institucionit në plane afatmesme. Raportet financiare diskutohen në dekanat dhe më pas përcillen në Senatën Akademik dhe Bordin e Administrimit të UT.

Referuar RVB-së si edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konstaton se të dhënat financiare të hartuara janë në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti por jo për program studimi.

[Ref: Dokumente të Buxhetit, Raporte Financiare dhe Kostoja e Programeve të Studimit të FSHS, Evidencë 2.34; Propozime për Projekt Buxhetin Afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.26; Propozime për Projekt Buxhetin Afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.27].

Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

Referuar RVB dhe Evidencës 2.34; 3.26; 3.27, paraqiten raporte financiare dhe kostoja e programeve të studimit të FSHS, të cilat përmbajnë të dhëna për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologjinë mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës. Në raportin financiar janë të përfshirë edhe të ardhurat e përftuara nga kontratat për Kërkim dhe Zhvillim siguruar përmes projekteve të ndryshme ku të përfshirë janë edhe pedagogë të Departamentit të Sociologjisë. Por nuk ka plane financimi për Departamentin apo programin e studimit "Bachelor" në "Sociologji".

[Ref: Dokumente të Buxhetit, Raporte Financiare dhe Kostoja e Programeve të Studimit të FSHS, Evidencë 2.34; Propozime për Projekt Buxhetin Afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.26; Propozime për Projekt Buxhetin Afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.27].

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për

GVJ konstaton se institucioni ka raporte financiare që përmbajnë pasqyra të hollësishme financiare vjetore të të ardhurave dhe të shpenzimeve. Referuar RVB, UT dhe FSHS kryejnë auditim të përvitshëm për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Por në dokumentacionin e vënë në

studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	dispozicion mungojnë të dhëna që e tregojnë për auditimin, vlerësimin e financimit dhe efektivitetin të tij financiar.		
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Bazuar në evidencën 2.34, konstatohet se në mbyllje të ciklit të plotë të studimeve, strukturat financiare të fakultetit dhe Universitetit të Tiranës dokumentojnë raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike. [Ref: <i>Dokumente të Buxhetit, Raporte Financiare dhe Kostoja e Programeve të Studimit të FSHS, Evidencë 2.34</i>].		
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar në raportet financiare të paraqitura në evidencën 2.34, konstatohet se FSHS dhe UT dëshmojnë qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të veprimtarisë së institucionit me qëllim rritjen e cilësisë akademike në të ardhmen. [Ref: <i>Dokumente të Buxhetit, Raporte Financiare dhe Kostoja e Programeve të Studimit të FSHS, Evidencë 2.34</i>].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për programin 'Bachelor' në 'Sociologji', bazuar në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tij mbështetëse, Departamenti i Sociologjisë zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik. Këto politika dhe procedura janë të përcaktuara nga Ministria, në Statutin e UT-së, Rregulloren e FSHS-së dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Departamenti i Sociologjisë harton dhe miraton kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Këto kritere bëhen publike në RASH dhe në faqen zyrtare të UT.

	<p>Numri i studentëve dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas zërave në tabelën e përcaktimit të kuotave të pranimit.</p> <p>Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit dhe rregulloren e diplomimit të FSHS-së.</p> <p><i>[Ref: Statuti i Universitetit të Tiranës, Evidencë 1.2; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidencë 2.4; Vendim Departamenti, Evidencë 3.13; Vendim Departamenti, Evidencë 3.14; Rregullore e Programit "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 3.6; Rregullore e Diplomimit, evidence 2.11; Vendim për Koordinatorin, Evidencë 3.11; 3.12; Rregullore e Shërbimit të Karrierës, Evidencë 2.25; Politika për Mbështetjen për Studentët dhe Strukturat e Tyre Organizative, Evidencë 2.26].</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, Universiteti përmes politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për student dhe studentëve të programit.</p> <p>Për përzgjedhjen e kandidatëve për student ngrihet një komision ad-hoc (anëtarë të njësisë bazë dhe specialist teknik për përlllogaritjen e rezultateve bazuar në kriteret). Kriteret dhe kuotat e pranimit bëhen publike para kalendarit të plotësimit të formularëve të aplikimit për degën nga maturantët.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidencë 2.4; Rregullore e Programit "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 3.6; Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3].</i></p>
<p>Kriteri 3: Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentet e paraqitura, kriteret e pranimit si: nota mesatare, kriteret e transferimit dhe njohjes së studimeve dhe të diplomimit janë të qarta dhe publikohen në faqen zyrtare të UT-së dhe FSHS-së.</p> <p>Në statutin e UT-së, në Rregulloren e UT-së, në Rregulloren e Programit të Studimit, janë të sanksionuara procedurat e regjistrimit të studentëve, ecuria gjatë studimit, mundësia e transferimit, njohja e dijeve dhe procedura e diplomimit.</p> <p><i>[Ref: Statuti I Universitetit të Tiranës, Evidencë 1.2; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Evidencë 2.4; Rregullore e Programit "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 3.6; Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 1.3].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Institucioni (Senati akademik) harton, miraton dhe bën publike në faqen zyrtare të UT -së, përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me Statutin e UT-së.</p> <p><i>[Ref: Vendim Departamenti, Evidencë 3.13; Vendim Departamenti, Evidencë 3.14; Faqja e Web e FSHS-së].</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015, vendimit të Këshillit të Ministrave për vendosjen e notës mesatare dhe rregullave të Maturës Shtetërore. Në dokumentet e</p>

<p>edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>paraqitura parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj, por nuk ka të specifikuar kritere të pranimit.</p> <p>Në RVB tregohet se programi i studimit ofrohet dhe në gjuhë të huaj por në dokumentin e paraqitur, konkretisht evidenca 2.7, programi 'Bachelor' në 'Sociologji' nuk është ndër programet e miratuara për t'u ofruar në gjuhën angleze në UT.</p> <p>[Ref: Vendim Departamenti, Evidencë 3.13; Vendim Departamenti, Evidencë 3.14; Lista e Programeve të Studimit e Miratuar për t'u Ofruar në Gjuhë të Huaj në Kuadër të Programit të Ndërkombëtarizimit, Evidencë 2.7].</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, FSHS informon publikun në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit, përmes publikimit të tyre në faqen zyrtare të UT-së, të FSHS-së, përmes faqes zyrtare në facebook të FSHS-së dhe nëpërmjet njoftimeve të publikuara në ambientet e fakultetit.</p> <p>[Ref: https://unitir.edu.al/?s=kriteret https://fshs-ut.edu.al/?s=kriteret+e+pranimit].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UT-së, në Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë, në Rregulloren për Mbështetjen e Studentëve dhe Strukturat e Tyre Organizative, dhe në vëzhgimin në fakultet gjatë vizitave, grupi i VJ, konstaton se institucioni publikon informacionet në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve. Këto informacione dhe vendime specifike publikohen në web-in e FSHS-së, rrjetet sociale, faqet zyrtare të pedagogëve. Studentët informohen edhe përmes mjeteve të komunikimit të brendshëm, si njoftime nga monitorët brenda fakultetit si afishime të posterave.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT-së, Evidencë 1.3; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.3; Rregullore për Mbështetjen e Studentëve dhe Strukturat e Tyre Organizative, Evidencë 2.26].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, bazuar në Statutin e UT-së, Rregulloren e UT-së dhe Rregulloren e Departamentit të Sociologjisë. Informimi bëhet në faqen zyrtare të web dhe njoftimeve në stendën brenda FSHS-së e në rrjete sociale.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT-së, Evidencë 1.3; Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë; Evidencë 3.3].</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në aktet rregullative të UT-së dhe FSHS-së, janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’. Këto kriteret dhe procedura janë të përcaktuara qartë në programet mësimore të secilës lëndë/modul të programit të studimit. Referuar RVB-së, çdo pedagogë në orën e parë të çdo lënde apo moduli duhet të informojë studentët me kriteret e lëndës dhe formën e vlerësimit të tyre. Gjithashtu programet e lëndëve, që përmbajnë kriteret e vlerësimit, ngarkohen në platformat e Teams dhe studentët mund t’i aksesojnë.</p> <p>Gjatë takimit me GVJ, studentët u shprehën se ata i kanë të qarta kriteret dhe procedurat e vlerësimit që orët e para të leksioneve.</p> <p>[Ref: Rregullore e UT-së, Evidencë 1.3; Rregullore e FSHS-së, Evidencë 2.4; Rregullore e Departamentit të Sociologjisë; 3.3; Programet e lëndëve, Evidencë 4.3].</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit, grupi i VJ, konstaton se institucioni ka të përcaktuar në rregulloret e tij kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’ dhe disponon Rregullore Diplomimi, Rregullore për Punimin e Diplomës dhe Program për Provimin e Formimit. Studentët informohen në lidhje me to përmes takimeve periodike që zhvillon departamenti dhe pedagogët.</p> <p>[Ref: Rregullore e FSHS-së, Evidencë 2.4; Rregullore për Diplomat e Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Sociologji”, Evidencë 3.6.1; Program i Provimit të Formimit, Evidencë 3.6.2; Rregullore e Diplomimit, Evidencë 2.11].</p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përpara fillimit të çdo viti akademik publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm.</p> <p>UT shpall axhendat e informimit të maturantëve dhe personeli akademik së bashku me punonjës të zyrës së karrierës së FSHS promovojnë programet e studimit. Fakulteti mbështet këshillin studentor të organizojë takime të hapura duke dhënë eksperiencat e tyre personale në formë diskutimi. Gjithashtu informimi bëhet përmes publikimit të njoftimeve zyrtare në web (nga vëzhgimi i faqes së FSHS, vihet re se aty ka broshura informuese për programin e studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’, dhe Guida e studentit), njoftime në rrjete sociale, në stendat e fakultetit etj. Gjithashtu grupi i RVB, referon se FSHS mban kontakte të vazhdueshme edhe me Drejtoritë dhe Zyrat arsimore, shkollat e mesme për të informuar studentët, si dhe merr pjesë në ditët e hapura dhe panairt e organizuara nga MASR.</p> <p>[Ref: Guida e Studentit, Evidencë 4.20; Politika për Mbështetjen për Studentët dhe Strukturat e Tyre Organizative 2018, Evidencë 2.27; faqja e Web e FSHS-së].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, planin mësimor, kohëzgjatjen e programit të studimit në faqen e zyrtare të UT-së, dhe faqen e web të FSHS-së. Gjithashtu në takimet informuese me zyrat vendore arsimore të qarqeve përmes broshurave informative dhe guidës së studentit. Informacion i zgjeruar publikohet dhe në monitorët e FSHS-së dhe stendat e fakultetit në takimet Work and Study. [Ref: Faqja zyrtare web e UT-së, Faqja web e FSHS-së].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti i Sociologjisë para nisjes së mësimimit me studentët e vitit të parë, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, organizon takime informuese mbi programin dhe planin mësimor, i cili gjendet i publikuar edhe në faqen zyrtare të FSHS-së. Bazuar në satutin e UT-së, dhe programin mësimor të lëndëve, çdo pedagog duhet të informojë studentët në orën e parë të mësimimit me përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të lëndës apo modulit. [Ref: Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Programet e lëndëve, Evidencë 4.3; Faqja zyrtare web e UT-së, Faqja web e FSHS-së].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Referuar RVB, specialistët e Këshillimit dhe Karrierës informojnë studentët mbi mundësitë të e punësimit, si dhe organizojnë trajnime për student se si të realizojnë një aplikim pune të suksesshëm. Mirëpo nuk ka të dhëna apo dokumente që ta tregojnë këtë, (në adresën që është shënuar në RVB nuk del informacion mbi këto takime informuese ose trajnime.) Gjithashtu RVB referon bazuar në dokumentacionin 3.21.1, se studentëve iu ofrohet një numër i konsiderueshëm mundësish mbi internship dhe trajnime (28 thirrje) apo mundësi punësimi (3 thirrje). Këto mundësi publikohen edhe në faqen e facebook të Departamentit të Sociologjisë dhe në faqen Alumni Bachelor në Sociologji. [Ref: Faqja zyrtare web e UT-së, Faqja web e FSHS-së; Tabelë Përmbledhëse për Trajnimet dhe Pjesëmarrje në Programe Kualifikimi për të Diplomuar, Evidencë 3.21.1].</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Referuar RVB-së, dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe takimit të GVJ me studentët, konstatohet se studentët informohen vazhdimisht nga sekretaria mësimore dhe koordinatojta e programit të studimit për procesin mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën. Nga vëzhgimi i faqes zyrtare të FSHS, konstatohet se njoftimet publikohen edhe në faqen e Web të FSHS-së, rrjete sociale dhe stenda e fakultetit. [Ref: Faqja zyrtare web e UT-së, Faqja web e FSHS-së; Facebook i Departamentit të Sociologjisë].</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Referuar grupit të punës për RVB, të gjithë strukturat në funksion të realizimit të programit të studimit ndjekin politikën e 'dyerve të hapura' dhe në cdo rast janë të disponueshëm për studentët. RVB nuk paraqet dokumente ose të dhëna për mundësinë e aksesimit të informacionit nga studentët në distancë. Nga vëzhgimi i faqes zyrtare</p>

	të FSHS dhe faqes së Departamentit të Sociologjisë, konstatohet se faqja përditësohet me njoftime dhe informacione të nevojshme për studentët. [Ref: Faqja zyrtare web e UT-së, Faqja web e FSHS-së; Facebook i Departamentit të Sociologjisë].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet për programin Bachelor në 'Sociologji'. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore dhe janë në formë elektronike në databazën e sekretarisë mësimore dhe regjistrave hardcopy. FSHS administron, ruan dhe arkivon çdo dokument dhe informacion zyrtar që lidhet me aktivitetin e tij, përmes Sektorit të Protokoll-Arkivës. [Ref: Të Dhëna për Regjistrimin, Ecurinë dhe Diplomimin e Studentëve, Tabela 21, Evidencë 4.8; Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9, neni 4; Të Dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve së "Bachelor" në "Sociologji", Evidenca 4.8.1, Tabela 23].
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë takimit të GVJ, me sekretarinë mësimore, si dhe në dokumentacionin (Evidencë 4.8) u evidentua se institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në vite. <ul style="list-style-type: none"> Në vitin akademik 2018-2019 rezultojnë të regjistruar 102 studentë (mesatarja në hyrje 8.1) Në vitin akademik 2019-2020 rezultojnë të regjistruar 106 studentë, (mesatarja në hyrje 7.4) Në vitin akademik 2020-2021 rezultojnë të regjistruar 94 studentë (mesatarja në hyrje 7.4) <p><i>Numri i studentëve ka ardhur në ulje ndër vitet e fundit dhe po ashtu edhe mesatarja në hyrje është gjithë ashtu është ulje nga viti 2018-2019 në vitin 2020-2021. Sugjerohet që të bëhet promovimi më efektiv i programit "Bachelor" në "Sociologji", për të rritur kërkesat dhe cilësinë e programit</i></p> <p>Në vitin 2019-2020 është transferuar 1 student dhe kanë rifilluar studimet 4 studentë.</p>

	<p>Për çdo student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga regjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim/diplomim të tyre.</p> <p><i>[Ref: Cilësia në Hyrje dhe në Dalje e studentëve "Bachelor" në "Sociologji", Tabela 21, Evidenca 4.8; Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Referuar RVB, sekretaria mësimore e FSHS-së mban regjistra për cdo program studimi, dosje personale të studentit, dokumentacionin e procedurave të transferimit apo ç'regjistrimit, procesverbale të provimeve etj.</p> <p>Në Evidencën 4.8, ka të dhëna për studentët e regjistruar e të diplomuar për vitet 2018-2021, dhe notën mesatare në hyrje, por nuk ka të dhëna për notën mesatare në dalje.</p> <p><i>[Ref: Cilësia në Hyrje dhe në Dalje e studentëve "Bachelor" në "Sociologji", Tabela 21, Evidenca 4.8; Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</i></p>		
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, të dhënat statistikore menaxhohen nga sekretaria mësimore duke zbatuar ruajtjen e privatësisë dhe i vendosen në dispozicion vetëm personave të autorizuar. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm e-student. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim.</p> <p><i>[Ref: Rregullore Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në UT, Evidencë 1.8; Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidencë 2.9].</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtëm të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti evidenton të dhëna mbi punësimin e studentëve përmes kontakteve që mban me ata pas diplomimit dhe hapësirës së Alumni në facebook (Evidenca 3.18), por në dokumentacionin e paraqitur nuk evidentohet nëse ka një database të saktë për raportin e studentëve të punësuar. Në raportet vjetore të punës për Departamentin e Sociologjisë ka të dhëna periodike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe përqindjes së punësimit të tyre në përputhje ose jo me fushën e studimit. Vihet re që vetëm 12 studentë nga 92 të diplomuar janë punësuar në një punë që ka të bëjë me fushën e tyre të studimit, por kjo sepse ata vazhdojnë ende studimet në ciklin e dytë të studimeve dhe kanë si prioritet në këtë periudhë më shumë sigurimin e të ardhurave që i japin pavarësi ekonomike.</p> <p>Grupi i VJ sugjeron ngritjen e një databazi të saktë për punësimin e studentëve.</p> <p><i>[Ref: Analizë Vjetore e Punës për Departamentin e Sociologjisë, Evidencë 3.18.1; Evidencë 3.18.2; Evidencë 13.8.3; Cilësia në Hyrje dhe në Dalje e studentëve "Bachelor" në "Sociologji", Tabela 21, Evidenca 4.8; Të Dhëna për Diplomimin dhe punësimin e Studentëve "Bachelor" në "Sociologji, Evidencë 4.8.1].</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Këto janë të sanksionuara në Statutin e UT-së (neni 129-137), ku përcaktohet që studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin akademik • Këshillin e etikës • Komisionet e përhershme të lejuara me statut • Këshillat e studentëve <p>Gjithashtu në nenet 40-43, përcaktohet e drejta e studentëve për të marrë pjesë në Komisionet e Mbarëvjatjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhëndhënies me Studentët, dhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Komisionin e Kurrikulës dhe Këshillin e Etikës.</p> <p>Studentëve iu rrijhet e drejta të organizojnë këshillat e studentëve, si organizime të pavarura, që kanë si qëllim promovimin e koordinimin e pjesëmarrjes së studentëve në organet drejtuese të Universitetit dhe Fakultetit.</p> <p>Nuk gjendet ne dosjen e akreditimit dokumenti 1.21 rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në UT.</p> <p>[Ref: Statuti I UT-së, Evidencë 1.2; Rregullore e UT-së, Evidencë 1.3; Rregullore e FSHS-së, Evidencë 2.4].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UT dhe FSHS garantojnë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik përmes përfaqësimit në organe kolegjiale vendimmarrëse, përmes mbështetjes në organizimet studentore, përmes përfshirjes në proceset e vlerësimit të mësimdhënies. Në fund të çdo semestri, studentët nëpërmjet një pyetësori japin mendimet e tyre në lidhje me performancën e çdo pedagogu, për mësimdhënien në leksione, seminare, komunikimin etj. Vlerësimi nga studentët mbetet anonim dhe i gjithë informacioni i dhënë prej tyre është konfidencial. Ky informacion përpunohet dhe shërben si raport për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik, me student dhe me përgjegjësën e departamentit, u evidentua se në raste ankesash apo problematikash, studentët pasi e parashitrojnë situatën nëpërmjet</p>

	<p>email-it, brenda 48 orësh marrin jo vetëm përgjigje zyrtare por edhe zgjidhje për situatën.</p> <p><i>[Ref: Manual i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së, Evidencë 1.13; Raport Vjetor për Monitorimin e Cilësisë (2018-2019, Evidencë 3.23].</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Siç përcaktohet në ligjin Nr. 80/2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, neni 70 dhe VKM Nr. 41, date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, në programin e studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’ shpërndarja e lëndëve dhe ngarkesa është e balancuar dhe kreditet e grumbulluara gjatë një viti akademik janë gjithsej 60. Orët për punë të pavarur të studentit për një vit akademik zënë, referuar planit mësimor të programit, më shumë se gjysmën e fondit të përgjithshëm të orëve mësimore vjetore. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm nuk është më shumë se sa 25 orë mësimore 50 minutëshe.</p> <p>Gjithashtu Institucioni bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion lejon transferimet dhe ekuivalentimin, për këtë ngre komisione në nivel departamenti për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara.</p> <p><i>[Ref: Statuti i UT-së, evidence 1.2; Rregullore e UT-së, Evidencë 1.3; Rregullore e FSHS-së neni 49-52, Evidencë 2.4].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, institucioni garanton përfshirjen e studentëve në komisione të cilat kanë impakt në përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve të studimit, si: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë; Komisionin e Kurrikulës; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>Gjithashtu studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit përmes pyetësorëve të realizuara. Në këto pyetësorë studentët ftohen të vlerësojnë përmbajtjen dhe organizimin e lëndës, mjedisin dhe format e mësimdhënies, burimet e të nxënit, cilësinë e mësimdhënies, format e vlerësimit, performancën e pedagogut si dhe për mendimin e tij se si mund të përmirësohet proçesi. Gjithashtu ka pyetësorë të cilët plotësohen nga studentët që diplomohen dhe japin mendimin e tyre rreth programit që kanë studiuar dhe se si mund të përmirësohet më tej, plotësimin e raportit të studentëve mbi cilësinë e programit akademik etj.</p> <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14; Të Dhëna Tabelore për Njësinë, Individët, Studentët e Angazhuar në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në FSHS, Evidencë 2.17].</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, studentët kanë një proçes transparent të vlerësimit të dijeve, që shprehet në rregulloren e FSHS-së, Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” dhe në programet e lëndëve. Provimet bëhen me</p>

<p>ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>sekretim dhe studenti ballafaqohet me pedagogun për të arsyetuar vlerësimin që ka marrë.</p> <p>Gjithashtu bazuar në evidencën 1.14, studentit i mundësohet të japë mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorëve që bën për 'Vlerësimin e pedagogut' (pyetja 10, 11) dhe në pyetësorin për 'Vlerësimin e lëndës nga student ka një rubrikë për vlerësimin.</p> <p>Studentët kanë mundësinë e ankimimit dhe rishikimit e rezultatit.</p> <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14; Rregullore e FSHS-së, Evidencë 2.4; Informacion Për Bazën Rregullore të Ankimimit të Studentëve, Evidencë 2.27; Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 3.6; Programet e Lëndëve, Evidencë 4.3].</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në FSHS-së është Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e Informacionit (Evidenca 2.25).</p> <p><i>Ky sektor ofron shërbime të shumëllojta informimi, orientimi, këshillimi e trajnimi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Informim për karrierën; ○ Orientim për karrierën; ○ Këshillim për karrierën ○ Trajnime për zhvillim karriere ○ Informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit; ○ Asistencë për praktikën profesionale; ○ Informim për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm; ○ Asistencë për veprimtaritë e studentëve; ○ Informim dhe orientim për tregun e punës <p>Fakulteti i Shkencave Sociale pasqyron të gjitha aktivitetet në faqen zyrtare të web dhe përditëson informacione të detajuara për studentët,</p>

	<p>stafin dhe palët e treta. Gjithashtu përdor për komunikimin e brendshëm e-mail zyrtare dhe platformën Teams.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Shërbimit të Karrierës, Evidencë 2.25].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Evidencën 2.25, FSHS ka një strukturë të posaçme për informimin e këshillimit të studentëve, që është Shërbimi i Karrierës. Referuar RVB ky shërbim i informimit të studentëve bëhet edhe përmes një zyre të vendosur në rektorat, Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentët dhe Publikun. Gjithashtu informacionet afishohen edhe në ekranet e instaluar në FSHS, në faqet zyrtare dhe rrjete sociale të institucionit, dhe në sekretari.</p> <p>Stafi i Departamentit të Sociologjisë ofron asistencën e tij për studentët përmes orareve të takimit në zyrë (Evidenca 3.25).</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Shërbimit të Karrierës, Evidencë 2.25; Orare Konsultimi me Studentët, Evidencë 3.25].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>FSHS kujdeset për studentët që nga momenti i regjistrimit dhe fillimit të studimeve e në vazhdim nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës sikurse edhe nëpërmjet pedagogëve të departamentit, koordinatorit të programit dhe sekretarisë mësimore. Specialistja e Këshillimit të Karrierës është në dispozicion të studentëve nga dita e hënë deri të premtën në orarin 8.30-16.30.</p> <p>Specialistja e Këshillimit dhe Karrierës ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Informim për karrierën; ○ Orientim për karrierën; ○ Këshillim për karrierën ○ Trajnime për zhvillim karriere ○ Informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit; ○ Asistencë për praktikën profesionale; ○ Informim për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm; ○ Asistencë për veprimtaritë e studentëve; ○ Informim dhe orientim për tregun e punës <p>Bazuar në Evidencën 3.21.1 kjo zyrë ka ofruar në bashkëpunime me sektorë të tjerë trajnime dhe aktivitete të shumta për studentët. Këto sektorë në bashkëpunim edhe me Departamentin e Sociologjisë vendosin marrëveshje të bashkëpunimit me kompani ku studentët mund të kryejnë praktikën profesionale.</p> <p><i>[Ref: Rregullore e Shërbimit të Karrierës, Evidencë 2.25; Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese në rang Programi Studimi për Praktikën Profesionale, Evidencë 3.21; Tabelë Përmbledhëse për Trajnime dhe pjesëmarrje në Programe Kualifikimi, Konferenca për të Diplomuarit, Evidencë 3.21.1].</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi</p>	<p>Referuar RVB dhe takimit me GVJ, specialistja e Këshillimit të Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të</p>

shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe u'a vë ato në dispozicion të studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Pas diplomimit specialistja kontakton studentët e diplomuar nëpërmjet email, numrit të telefonit dhe rrjeteve sociale e harton relacione për punësimin e studentëve. [Ref: Rregullore e Shërbimit të Karrierës, Evidencë 2.25; Studim Tregu, Departamenti i Sociologjisë, Evidencë 3.31; Të Dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve "Bachelor" në "Sociologji", Evidencë 4.8.1].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të ligjit, standarteve shtetërore të cilësisë, institucioni ka një sistem të sigurimit të cilësisë, ka struktura dhe procedura specifike. Këto procedura janë të përcaktuara në statutin e UT, Kreu X, ku shprehen qartë parimet e funksionimit të tij, funksionet e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, strukturat e saj dhe funksionet e tyre. Politika e UT-së në këtë drejtim janë të përcaktuara edhe në: <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i cilësisë; • Rregulloren për Vlerësimin e Performanceës së Personelit Ndihmës Akademik dhe Administrative në UT; • Manuali për Vlerësimin e Performanceës së Personelit Akademik të UT-së. Gjithashtu në Planin e Zhvillimit Strategjik të FSHS një nga objektivat është zhvillimi i sistemit të sigurisë të cilësisë. Në FSHS që nga viti 2017 është krijuar Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (Evidencë 2.12) dhe kanë hartuar një politikë të qartë të sigurimit të cilësisë përmes Rregullores së Sigurimit të

	<p>Cilësisë në të cilën përcaktohen procedurat e mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolin e përgjegjësitë e NJSC në FSHS.</p> <p><i>[Ref: Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Strategjia e Zhvillimit të FSHS-së 2018-2023, Evidencë 2.3; Vendim i FSHS-së për Ngritjen e NJSC, Evidencë 2.12; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, Evidencë 2.14].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT-së, Fakulteti i Shkencave Sociale ka të ngritur një Komision të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, që nga viti 2017. Referuar RVB, FSHS ka përcaktuar persona përgjegjës nga çdo departament i Fakultetit, të cilët koordinojnë punën për procesin e sigurimit të cilësisë dhe bashkëpunojnë me zyrën e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Në KSC përfshihen dhe studentët (Evidenca 2.17), dhe në GVB.</p> <p><i>[Ref: Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Strategjia e Zhvillimit të FSHS-së 2018-2023, Evidencë 2.3; Vendim i FSHS-së për Ngritjen e NJSC, Evidencë 2.12; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, Evidencë 2.14; Përshkrim i Veprimtarisë së NJSC-së së FSHS, Evidencë 2.13; Të Dhëna Tabelore për Njësinë, Individët, Studentët e angazhuar në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Nivel FSHS, Evidencë 2.17].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe miratuar Paketën e Sigurimit të Cilësisë që përmban paketën e Instrumenteve të Cilësisë. Kjo paketë përmban këto instrumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrument i vlerësimit të lëndës nga studenti • Instrument nga studentet që janë ne prag diplomimi për cilësinë e programit të studimit. • Raport nga studentët (të diplomuar) për cilësinë e programit • Vlerësim për pedagogun • Raport i departamentit • Raport i punëdhënësit (ku janë të punësuar student të UT-së) • Raport i vetëvlerësimit nga pedagogu • Formular vlerësimi nga personeli akademik (niveli i kënaqësisë në punë). • Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut • Matricë përmbledhëse e vlerësimit të pedagogut. <p>Referuar RVB rezultatet e këtyre instrumenteve analizohen dhe komunikohen.</p> <p>Në nivel fakulteti kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik. Përgjegjësi i Departamentit të Sociologjisë në përfundim të vitit akademik vlerëson performancën e stafit akademik përkatës (vlerësim i mësimdhënies, aktivitetit shkencor dhe kontributit për institucionin.)</p> <p>Në përfundim të këtij procesi hartohen raportet vjetore në nivel departamenti duke evidentuar problematika dhe duke adresuar ato për zgjidhje në kuadër të përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14; Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor</i></p>

	<i>për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1; Analizë Vjetore e Punsë për Departamentin të Sociologjisë, Evidencë 3.18].</i>		
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Institucioni së bashku me KPSSC-në, dhe NJSBC-në kanë hartuar e ndjekin politika të qarta dhe procedura periodike për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së programeve. Këto politika e procedura janë të sanksionuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në UT; - Manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së; - Manualin e cilësisë; - Rregulloren e NJSBC në fakultet; - Rregulloren për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrative; <p>Në këto dokumente përcaktohet modalitetet e monitorimit të cilësisë dhe afatet kohore të realizimit të tyre.</p> <p><i>[Ref: Manuali i Cilësisë, Evidencë 1.11; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, Evidencë 2.14].</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit, institucioni nuk ka njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit 'Bachelor' në 'Sociologji'.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë, është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit "Bachelor" në "Sociologji" dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse për sigurimin e cilësisë. Koordinatorin e programit dhe drejtuesin e departamentit janë përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e programit të studimit.</p> <p>NJSBC në mënyrë periodike mbledh të dhëna të studentëve lidhur me programin e studimit, pedagogët, programin e lëndëve etj.</p> <p>Në fund të vitit akademik departamenti bën një analizë vjetore për ecurinë e programit të studimit në tërësi, jep të dhëna sasiore dhe përshkrimore për aspekte të ndryshme të tij dhe mbyllet me disa objektiva që synohen për vitin e ardhshëm akademik në kuadër të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Referuar RVB, Departamenti rishikon në mënyrë periodike mundësitë për përmirësimin e programit të studimit, duke u bazuar në analizat vjetore të punës ose me propozim nga një anëtar i departamentit dhe</p>

	<p>diskutohet në department. Kur departamenti bie dakort atëherë ndërmerren hapat për ndryshimin me qëllim përmirësimin e tij.</p> <p><i>[Ref: Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1; Analizë Vjetore e Punës për Departamentin të Sociologjisë, Evidencë 3.18; Informacion për Politikën e Zhvillimit dhe të Përmirësimit të Kurrikulave, Evidencë 2.16].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma dhe procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’. Këto mekanizma janë hartuar dhe vënë në zbatim nga NJSBC. Të dhënat që nxirren nga përdorimi i këtyre instrumenteve, (për cilësinë e mësimdhënies, larmia e materialeve, përmbajtja e lëndëve, angazhimi i stafit akademik, mjediset dhe infrastruktura etj.), analizohen dhe pasqyrohen me raporte periodike nga NJSBC.</p> <p><i>[Ref: Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji” (2021-2024), Evidencë 3.5; Raport Vjetor për Monitorimin e Cilësisë (2018-2019), Evidencë 3.23; Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14].</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për mbarëvajtjen e programit të studimit. Në paketën e instrumenteve të sigurimit të cilësisë janë këto instrumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrument i vlerësimit të lëndës nga studenti • Instrument nga studentet që janë ne prag diplomimi për cilësinë e programit të studimit. • Raport nga studentët (të diplomuar) për cilësinë e programit • Vlerësim për pedagogun • Raport i departamentit • Raport i punëdhënësit (ku janë të punësuar student të UT) • Raport i vetëvlerësimit nga pedagogu • Formular vlerësimi nga personeli akademik (niveli i kënaqësisë në punë). • Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut • Matricë përmbledhëse e vlerësimit të pedagogut. <p>Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente i shërbejnë NJSBC-së për të hartuar raporte periodike.</p> <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14; Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1; Raport Vjetor për Monitorimin e Cilësisë (2018-2019), Evidencë 3.23].</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion. Institucioni në fund të vitit akademik kryen analizën e rezultateve dhe identifikon nevojat për përmirësim me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të studimit. Këto analiza i përcillen autoriteteve</p>

përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	vendimmarrëse për programin e studimit, përkatësisht Përgjegjësit të Departamentit të Sociologjisë dhe Dekanit të FSHS-së. Rezultatet dokumentohen në analiza/raporte vjetore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore të FSHS-së. [Ref: Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1; Raport Vjetor i Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.18].		
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet për mësimdhënien, kërkimin shkencor, bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe projektet, përfshirjen e studentëve, angazhimin e personelit etj. Në raportin vjetor të Departamentit të Sociologjisë janë të identifikuar problematikat dhe masat e marra për adresimin e tyre dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Gjithashtu në Strategjinë e Zhvillimit të FSHS-së (2.3) dhe Strategjinë e Zhvillimit të Programit të Studimit ‘Bachelor’ në ‘Sociologji’ (Evidenca 3.5) janë të përfshira rezultatet e pritshme, evidentimi i pikave të dobëta dhe plani i veprimit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të ofruar. [Ref: Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1; Raport Vjetor i Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.18; Strategjia e Zhvillimit të FSHS-së, Evidencë 2.3; Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit “Bachelor” në “Sociologji”, Evidenca 3.5].		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit “Bachelor” në “Sociologji” kryhet në mënyrë periodike nga NJSBC-së, dhe institucioni përfshin dhe publikon rezultatet e vlerësimit nëpërmjet një raporti të përvitshëm. Departamenti e përdor këtë dokumentacion në kuadër të akreditimit të programeve dhe vlerësimeve të brendshme periodike. Rezultatet e vlerësimit, përfshihen në raportet vjetore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. [Ref: Raport Vjetor i Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.23; Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1].

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe RVB për kryerjen e vlerësimit të programit institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorim nga KPSC Në nivel institucional; - Monitorim nga koordinatori i programit të studimit; - Vlerësime nga NJSBC; - Monitorime nga drejtuesi i njësisë bazë; <p>NJSBC për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente të ndryshëm si pyetësor për studentët në lidhje me lëndën, mësimdhënien, angazhimin e pedagogëve, për programin etj.</p> <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14].</i></p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar programeve mësimore të lëndëve të programit të studimit (Evidenca 4.3) dhe formave të kontrollit të njohurive (Evidenca 3.12), institucioni përdor për matjen e rezultateve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuar; - Vlerësime në auditor gjatë seminareve; - Vlerësime të punëve individuale/detyrave të kursit; - Vëzhgimet gjatë praktikës; - Rezultatet e arritura dhe vlerësimet. <p>Në çdo program të lëndëve është e specifikuar pesha e secilit komponent të vlerësimit.</p> <p><i>[Ref: Programet e Lëndëve, Evidencë 4.3; Paketa e Vlerësimit të Cilësisë, 1.14].</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Metodat e tërthorta të vlerësimit që implementohen janë sondazhet që përdorin këto formate:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrumenti i vlerësimit të lëndës nga studenti • Instrumenti nga studentet që janë në prag diplomimi për cilësinë e programit të studimit. • Raport nga studentët (të diplomuar) për cilësinë e programit • Vlerësim për pedagogun <p>Për vlerësimin përdoren dhe raporte të personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raport i departamentit • Raport i punëdhënësit (ku janë të punësuar studentë të UT) • Raport i vetëvlerësimit nga pedagogu • Formular vlerësimi nga personeli akademik (niveli i kënaqësisë në punë). • Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut • Matricë përmbledhëse e vlerësimit të pedagogut. • <p><i>[Ref: Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Evidencë 1.14].</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="width: 33%;"></td> <td style="width: 33%;"></td> <td style="width: 33%;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UT parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë anëtarëve të komunitetit të tij në sigurimin e cilësisë, duke i respektuar ata dhe duke i dhënë mundësi secilit të japë kontributin e tij për përmbushjen e objektivave të cilësisë me përgjegjshmëri. (Evidenca 1.6, neni 6). Në këtë proces duhet të përfshihen edhe palët të interesuara jashtë institucionit (Evidenca 1.6, neni 7, pika 1). Mirëpo në organet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë nuk parashikohet të ketë aktorë të jashtëm të përfshirë. <i>[Ref: Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, Evidencë 1.6; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në FSHS Kreu III, Evidenca 2.14].</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët dhe studentët në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Këto përgjegjësi dhe detyra janë të përcaktuara në Statutin e UT-së, Rregulloren e NJSC të FSHS 2020 dhe në Përshkrimin e Veprimtarisë së NJSC. <i>[Ref: Statuti i UT-së, Evidencë 1.2; Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, Evidencë 1.6; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në FSHS Kreu III, Evidenca 2.14].</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit janë të përfshirë njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, personeli akademik dhe studentët (Evidenca 2.17). Grupi i punës për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit propozohet nga njësia përgjegjëse për programin dhe miratohet nga dekani. <i>[Ref: Të Dhëna Tabelore për Njësine, Individët, Studentët e Angazhuar në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Nivel FSHS].</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Referuar RVB vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e NJSBC janë: <ul style="list-style-type: none">• Integriteti;• Pavarësia dhe objektiviteti;• Profesionalizmi• Komunikimi dhe Informimi; Vlera të tilla garantohen përmes akteve rregullatore të njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke synuar përmirësimin dhe avancimin në funksion të rritjes së cilësisë, duke përdorur si mekanizma pune përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm me rotacion nga njëra periudhë vlerësimi në tjetrën. <i>[Ref: Manuali i Cilësisë, Evidencë 1.11; Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në FSHS Kreu III, Evidenca 2.14].</i>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Referuar RVB pjesë e vlerësimit të brendshëm bëhen edhe ekspertë të jashtëm të interesuar duke dhënë ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Mirëpo përveç tabelës së marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka realizuar departamenti në kuadër të realizimit të praktikës nuk ka evidenca që ta tregojnë këtë. Në organet dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë nuk parashikohet të ketë aktorë të jashtëm të përfshirë. Në përbërjen e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm nuk ka ekspertë të jashtëm. GVJ sugjeron që në procesin e sigurimit të cilësisë të përfshihen edhe aktorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Edhe pse përfshirja e tyre nuk është detyrim ligjor, ata mund të japin ekspertizë të vlefshme në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizmi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. Në faqen e Web janë të publikuara Statuti i UT-së dhe Strategjia e Zhvillimit të UT-së, dokumente në të cilat janë të zhvilluara politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Gjithashtu NJSBC në nivel njësie kryesore publikon raportet e vetëvlerësimit dhe i vë ato në dispozicion të studentëve dhe stafit. <i>[Ref: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Evidenca 2.19].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni në hartimin dhe publikimin e rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit mbështetet dhe respekton aktet rregullatore, lirinë akademike, etikën dhe ruajtjen e të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit analizohen në Departamentin e Sociologjisë dhe në fakultet. Këto rezultate iu bëhen të ditura edhe studentëve në takime informuese ose dëgjesa me studentët.</p> <p><i>[Ref: Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në UT, Evidencë 1.8; Privatësia, Evidencë 1.9; Raport Vjetor i Departamentit të Sociologjisë, Evidencë 3.18; Raport Vjetor për Veprimtaritë e Kryera 2019-2020, Evidencë 2.18-2; Raport Vjetor për Veprimtaritë e kryera 2020-2021, Evidencë 2.18-1].</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë</p>	<p>Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultatet e vlerësimit për programin e studimit shoqërohen me</p>

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	rekomandime, objektiva dhe plan veprimi për zgjidhjen e problematikave apo mangësive të ndryshme.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë kanë ndërtuar strategji të zhvillimit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit duke marrë parasysh dhe duke u mbështetur në informacionet e nxjerra rëga rezultatet e vlerësimit të paraqitur në raporte dhe analiza vjetore. Në kuadër të procesit të akreditimit, institucioni e përfshin informacionin në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të gjithë hallkat institucionale ndërveprojnë në funksion të optimalizimit të veprimtarisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar RVB dhe takimeve me studentët dhe personelin akademik të programit, FSHS dhe Departamenti i Sociologjisë në mënyrë periodike mundëson takime me studentët dhe personelin, duke nxitur shprehjen e opinionëve lidhur me procesin mësimor me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Sociologji” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit ofron mundësi për integrimin në procesin e ndërkombëtarizimit. Kjo shihet dhe nga partneritetet e lidhura dhe ato në zhvillim me institucione jashtë Shqipërisë.
2. Aksesit i librave akademikë në fushën e sociologjisë dhe në nënfusha të tjera të Shkencave Sociale në Bibliotekën fizike dhe online me akses të siguar nga Universiteti, Fakulteti ose Departamenti.
3. Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik me tituj e grada shkencore dhe rritja e vazhdueshme e burimeve njerëzore.

Pika të dobëta:

1. Nevoja për mbështetje të botimeve në revista të indeksuara me Scopus apo Web of Science dhe teksteve universitare nga IAL për botime monografike, në mënyrë që të shërbejë si një kontribut i rëndësishëm për pasurimin e literaturës së ofruar për studentët në lëndë specifike. **(Standarti III.4, Kriteri 4)**
2. Nevoja për rritjen e mobilitetit të studentëve drejt universiteteve të huaja dhe përfshirjes së tyre në projekte ndërkombëtare. **(Standarti III.7, kriteri 9, kriteri 10)**
3. Nevoja e një promovimi më efektiv të programit “Bachelor” në “Sociologji”, për të rritur kërkesat dhe cilësinë e programit. **(Standarti V.4, kriteri 2)**

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që strukturat përkatëse të angazhohen më shumë për të gjetur format e duhura për një promovim e marketing më efikas të programit, përmbajtjes e objektivave të tij pranë institucioneve shtetërore e private, si dhe shoqërisë civile, për të krijuar më shumë kushtet për akses punësimi pranë tyre, duke argumentuar rëndësinë e nevojën e ekspertëve në fushën e studimeve në Sociologji.
2. GVJ rekomandon të krijohet një mundësi më e madhe e mbështetjes financiare nga ana e institucionit për personelin akademik, lidhur me pjesëmarrjen në konferenca dhe botime e publikime shkencore ndërkombëtare sipas kriterëve të përcaktuara.
3. GVJ rekomandon që IAL të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve nga projektet e financuara nga AKSHI, projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. GVJ sugjeron rritjen e numrit të partneriteteve dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve përmes projekteve evropiane të shkëmbimit Erasmus + dhe të tjera të ngjashme.
5. RVJ sugjeron që webfaqja e IAL të jetë më e decentralizuar, duke krijuar mundësi e një faqeje interaktive, për të ofruar një organizim më efektiv të informacionit nga Departamenti i Sociologjisë, siç janë rubrika e stafit dhe aktivitetet e njësisë, si dhe departamenti të jetë aktiv në rrjetet sociale, si një mundësi e mirë e marrëdhënieve me publikun e interesuar, e sidomos për kandidatët për student në këtë program studimi.

6. GVJ sugjeron përfshirjen e bashkëpunëtorëve/ekspertëve të jashtëm, që kanë lidhje me programin e studimit, në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë që të mund të japin mendime të vlefshme në lidhje me programin dhe përmirësimin e tij.
7. GVJ rekomandon, që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Sociology" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"

Strengths and Affirmations:

1. The study program curriculum provides opportunities for integration into the internationalization process. This can be seen from the established and developing partnerships with institutions outside Albania.
2. Access to academic books in the field of sociology and other subfields of Social Sciences in the physical and online Library with access provided by the University, Faculty or Department.
3. Continuous qualification of academic staff with scientific degrees and continuous growth of human resources.

Weaknesses:

1. The need for support for publications in journals indexed with Scopus or Web of Science and university texts from HEIs for monographic publications, in order to serve as an important contribution to enriching the literature offered to students in specific subjects. **(Standard III.4, Criterion 4)**
2. The need to increase student mobility to foreign universities and their involvement in international projects. **(Standard III.7, criterion 9, criterion 10)**
3. The need for a more effective promotion of the "Bachelor" program in "Sociology", to increase the requirements and quality of the program. **(Standard V.4, criterion 2)**

Recommendations:

1. External Evaluation Group recommends that the relevant structures engage more to find the right forms for a more efficient promotion and marketing of the program, its content and objectives near state and private institutions, as well as civil society, to create more conditions for employment access to them, to show the need of experts in the field of Sociology studies.
2. EEG recommends creating a greater possibility of financial support from the institution for academic staff, related to participation in conferences and international scientific publications according to the defined criteria.
3. EEG recommends that HEI provide alternative forms of generating funds from projects financed by national and international projects.
4. EEG suggests increasing the number of partnerships and mobility of academic staff and students through European exchange projects Erasmus + and other similar ones.

5. EEG suggests that the HEI website be more decentralized, creating the possibility of an interactive site, to provide a more effective organization of information from the Department of Sociology, such as the staff column and unit activities, as well as the department of be active in social networks, as a good opportunity for relations with the interested public, and especially for student candidates in this study program.
6. EEG suggests the involvement of external collaborators/experts, who are related to the study program, in the evaluation and internal quality assurance processes, so that they can give valuable opinions about the program and its improvement.
7. EEG recommends that the institution initiate incentive mechanisms for staff to be able to publish scientific articles in prestigious international journals indexed in the Scopus or Web of Science databases.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X